

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7824 E hënë 18 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**

Tallja me ndjenjat e shqiptarëve në FYROM vazhdon. Referendumi në këtë vend nxori frustrimet e qytetarëve sl-lavomagedonas të cilët e kanë humbur rrugën drejt ...  
Vijon në faqen 20

Nga ARSIM SINANI

**Shtatë gabimet e Zaevit**



**Opinion** *i* **Ditës**

Protesta e pardeshme nuk dësh-toi. Ajo ia arriti qëllimit të shumicës së njerëzve të revoltuar dhe pa perspektivë pune që mbushën bulevardin...  
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Dy protesta dhe një mësim**



**INTERVISTA**

Ish-ministrja: Zgjedhjet e parakohshme të pashmangshme

## Gara në Tiranë, Gjoshja: Zgjedhim një kandidaturë të denjë përballë PS

“LSI s’ka asnjë përçarje, u çlirua nga ata që e deshën për interesa”

Nga VALENTINA MADANI

LSI është partia që pati më shumë ‘tradhtarë’ brenda opozitës pas djegies së mandateve të deputetëve. Por ish-ministrja e Integritimit Klajda Gjoshja beson se LSI nuk ka asnjë përçarje, përkundrazi sipas saj ka një çlirim nga të gjithë ata që ...  
Në faqen 4

## PERGATITJET E KONGRESIT, S’KA ENDE LISTE FINALE ME EMRAT E 30 QERSHORIT

# RAMA Mbledh kryesinë, “PEZULL” KANDIDATET E PS

Largimi i aleatëve të 2015, ‘Rilindja’ humb 430 mijë votat, tabelat përkatëse. Cilat janë forcat politike që braktisën koalicionin e majtë...



(Në foto) Edi Rama, duke folur gjatë punimeve të Kongresit të Partisë Socialiste

Në faqen 2-5

**DETAJET E NGJARJES**

**Vrasja te liqeni, pranga mikut të Baxhinofskit, dëshmia e plotë**

Në faqen 6

**REPORTAZH**

**Një ditë mes njerëzve që përballen me varfërinë**

Në faqen 9

**KALENDAR I PLOTE**

**Zbardhen emrat e 390 mësuesve që do t’i nënshtrohen provimit të shtetit**

Në faqen 7-8

**LISTA E PLOTE**

**Dosjet 1993-2013, lista me 6 611 pronarët që do të marrin paratë**

Në faqen 10-12

### SITUATA NE FUTBOLL



**Skandal, presidenti i “Kastriotit” kërcënon drejtuesin e “Panorama Sport”**

Në faqen 22

Mjekja gastrohepatologe: Kujdes, nëse vëreni këto simptoma, konsultë me specialistin

## Rozana Aleks: Mënyrat e trajtimit të gurit në tëmth

Ylli Merja: Si të kuroni sëmundjet e bajameve me bimë mjekësore

NGA VOLTIZA DURO

Kur lëngu i grumbulluar në fshikëzën e tëmthit mpikset mund të formohen gurët në tëmth, që jo në pak raste sjellin një sërë shqetësimesh te pacienti. Në një intervistë për suplementin “Life Pages” në



‘Gazeta Shqiptare’, mjekja gastrohepatologe dr. Rozana Aleks tregon të gjitha simptomat që nuk duhen neglizhuar, llojet e gurëve në tëmth si dhe mënyrat e diagnostikimit të saktë. Ajo shton se kategoritë më të riskuara janë gratë ...

Suplement

## SITUATA POLITIKE PROTESTAT

Socialistët do diskutojnë për situatën politike dhe axhendën e kongresit të 23 marsit

# Kriza, PS mbledh kryesinë surpriza në kongres

Prezantohen vetëm disa nga kandidatët për kryebashkiakë

Në kulmin e tensionit dhe të një paqartësie politike për atë që mund të vijë nesër, Partia Socialiste do të mbledhë sot kryesinë e saj. Burime nga selia rozë kanë bërë me dije se mbledhja e kryesisë pritet të fillojë rreth orës 9:00 të mëngjesit me një rend të gjerë pikash për diskutim. Natyrisht që pika kryesore mësohet se do jetë aktualiteti politik dhe sjellja që duhet të ketë Partia Socialiste në vijim, në kushtet kur opozita ka braktisur institucionet dhe ka dalë në rrugë për të protestuar. Burime nga PS kanë bërë me dije se nuk pritet të ketë ndryshim nga strategjia e ndjekur deri më tani nga mazhoranca, për të vijuar plotësimin e vendeve vakante në Kuvend deri në shterimin e listave shumëëmërore të partive për të krijuar një Kuvend sa më funksional me një opozitë të re. Gjithashtu, PS do të vijojë të mbajë një qëndrim të prerë për të ofruar dialog me opozitën, por edhe duke u përpjekur që të mos lëshojë pe sa i përket ndryshimit të mundshëm të datës së mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme vendore. Socialistët në vazhdimësi janë përpjekur që të bëjnë të qartë se zgjedhjet do mbahen në datën e dekretuar nga presidenti më 30 qershor.

### KANDIDATËT

Një tjetër pikë e diskutimeve të kryesisë së sotme është edhe rendi i ditës së Kongresit që do mbahet të shtunën në 23 mars. Kështu, mësohet se kryesia do të miratojë axhendën e diskutimeve, ku duket se do të mungojë pika për miratimin e listës së kandidatëve për kryetar bashkie siç edhe ishte përcaktuar më parë. Sipas burimeve nga PS në kongres do bëhet prezantimi i disa kandidatëve si modele të suksesshme të qeverisjes lokale të PS-së, por nuk do ketë miratim të një liste të plotë kandidatësh. Kjo edhe për vetë faktin se Partia Socialiste nuk ka zhvilluar një proces propozimesh dhe përzgjedhës brenda strukturave të partisë për



## Protesta, Veliaj: Kjo është Tirana qytetare që e do progresin

Mijëra qytetarë iu bashkuan dje festimeve të organizuara nga Bashkia e Tiranës me rastin e "Ditës së Verës", ndërsa kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj gjeti rastin të përcjellë dhe një mesazh për protestën e opozitës. Duke folur dje për mediat, nisur edhe nga masiviteti në këto festime, ai theksoi se ky është një tregues se shumica e qytetarëve të Tiranës e duan qytetin dhe janë kundër dhunës. "Jam shumë i lumtur që sot, Tirana e vërtetë, ata që jetojnë në Tiranë, që e duan Tiranën, që duan familjen e tyre më shumë se sa partinë, që duan që ky vend të ecë përpara më shumë se sa ata që duan ta shkatër-

kandidatët që do konkurrojnë për kryetar bashkie. Të njëjtat burime bëjnë me dije se kjo shtyrje e miratimit të listës së plotë mund të vijë edhe për shkak të situatës politike në të cilën ndodhet vendi. Kështu, socialistët nuk duan që të bëjnë publik gjithë kandidatët e tyre në një kohë kur nuk është ende e qartë nëse

rojnë, janë sot me shumicë. Në pak orë nga shkatërrimi i djeshëm, Tirana ka ngritur kokën. Të gjithë janë këtu me familjet e tyre, jo burrat e dhunshëm, por gra, fëmijë, gjysh, nipër e mbesa, sepse kjo është Shqipëria e vërtetë! Sot, edhe mediat e huaja që janë në Tiranë dhe po ndjekin zhvillimet, kanë shansin të shohin Shqipërinë e vërtetë, Shqipërinë që do të ecë përpara, Shqipërinë që do të bëjë progres dhe Tiranën që gjithmonë e më shumë është qyteti i ëndrrave tona", tha kryebashkiaku i Tiranës. Ai falënderoi të gjithë qytetarët që sipas tij u distancuan nga aktet e dhunës dhe që dje kishin dalë për të festuar ardhjen e stinës së ngrohtë. "Kjo është një festë që bash-

kgjedhjet vendore do mbahen në 30 qershor ose jo.

### STATUTI

Një tjetër pikë e diskutimeve të sotme të kryesisë do jetë edhe miratimi i një drafti paraprak i ndryshimeve në statutin e partisë. Asambleja Kombëtare e muajit dhjetor ngriti një grup pune për hartimin e një statuti të ri që

### STATUTI

Një tjetër pikë e diskutimeve të sotme të kryesisë do jetë edhe miratimi i një drafti paraprak i ndryshimeve në statutin e partisë. Asambleja Kombëtare e muajit dhjetor ngriti një grup pune për hartimin e një statuti të ri që t'i përgjigjet zhvillimeve të kohës.



### SHKURT

## Balliu: Rama në spital, reagon kryeministri: Bëmë baba të të ngjaj

Ish-deputeti demokrat, Klevis Balliu publikoi dje një mesazh ku pretendonte se kryeministri Edi Rama kishte përfunduar në spital menjëherë pas protestës së 16 marsit. Duke iu referuar burimeve të tjera, Balliu theksoi se kishte pësuar një parainfarkt. "Mësova nga disa burime se kryeministri Rama është shtruar në një spital privat, pasi ka pësuar një parainfarkt. Gjendja e tij shëndetësore reflekton qartazi gjendjen e rënduar politike. Skandalat si vjedhja e Unazës, kanabizimi i vendit, droga, implikimet e qeverisë me krimin, dosja 339 apo 184 dhe patjetër revolta qytetare janë arsye të gjendjes së tij. Duke i uruar shërim të shpejtë, i kërkoj që të japë dorëheqjen për të mirën e tij", - shkroi Balliu. Menjëherë pas këtij lajmi erdhi reagimi i këshilltarit të Ramës, Endri Fuga dhe më pas e vetë kryeministri. Rama hodhi poshtë si të pavërtetë këtë lajm. "Bëmë baba të të ngjaj! Mirë Kadriu i Bahriallut më paska çuar në spital me tërë kadrinjtë e portaleve, po ju, o miq, që merakoseni s'i keni hequr akoma kaza-në nga iphonët?! Nejshe, sa dola nga studioja e Adit pas një dite larg qytetit, larg kadrinjeve dhe rrëmetit. FLM për merakun", - shkroi Rama.

## "Gërdeci"/Humbi gjyqin në SHBA, Ballia: SPAK të hapë hetimet

Një ditë pas publikimit në media të lajmit se gjykata në Florida të SHBA-së kishte marrë vendim kundër Shkëlzen Berishës, djali i ish-kryeministrit Sali Berisha, i cili paditi autorin e librit "Armët dhe djemtë", për të mohuar rolin e tij të trafikimit të armëve, kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla ka kërkuar rihapjen e hetimeve edhe në Shqipëri. Nëpërmjet një reagimi në rrjetet sociale Taulant Balla thotë se vendimi i gjykatës amerikane është një indicie për Strukturën e Posaçme Anti Korrupsion që të rihapë hetimet për këtë çështje. "Është një akt juridik, indicie e pakontestueshme për SPAK, ky vendim gjykatë për të rihapur hetimin mbi rolin e Shkëlzen Sali Berishës në dy aferat e mëdha të Gërdecit, atë të demontimit dhe atë të trafikimit të armëve, dy histori ku ky ka vepruar me të njëjtin grup pune. Provat janë pa fund dhe shumë më tepër se ato që i kanë njaftuar gjykatës së Floridës. Drejtësia amerikane ka hedhur tashmë poshtë pretendimet e berishëve duke pushuar çështjen që Shkëlzen Berisha ka ngritur ndaj autorit amerikan Guy Lawson, autor i librit për Gërdecin "Arms and the Dudes", shkruan Taulant Balla në Twitter.



Uniformat blu procedojnë 33 persona dhe arrestojnë 14 prej tyre

# Dhuna në protestë, procedohet penalisht numri 2 i PD-së

*Sekretari i Përgjithshëm, organizator i protestës*

Numri 2 i demokratëve, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi ka përfunduar i proceduar penalisht për veprimet e dhunshme mbi institucionet shtetërore të shkaktuara gjatë protestës së opozitës që u mbajt të shtunën. Policia e Shtetit ka bërë publike të dhënat lidhur me hetimet paraprake të kryera pas ngjarjeve që shoqëruan protestën e 16 marsit, ku protestuesit u përplasën me forcat e policisë në ambientet para Kuvendit të Shqipërisë. Sipas uniformave blu janë 33 persona të proceduar për aktet e dhunës në protestën para parlamentit. Ndërkohë që vetëm 14 prej tyre janë arrestuar për veprime të dhunshme, 11 janë proceduar në gjendje të lirë dhe 7 të tjerë janë shpallur në kërkim. "Policia e Tiranës nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arrestuar 14 shtetas, për veprime të dhunshme mbi institucionet kushtetuese, mbi policinë dhe për shkatërrimin e pronës gjatë zhvillimit të protestës së opozitës Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integritet më datë 16.03.2019.



Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi

**ARRESTIMET**

"Janë arrestuar 14 persona për konsumimin e elementëve të veprave penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", "Goditje për shkak të detyrës", "Kundërshtim me dhunë të punonjësit të policisë", "Prishje të rendit dhe qetësisë publike" dhe "Mbajtja dhe përdorimi i lëndëve plasëse"

**SHKURT**

**Përdorimi i gazit lotsjellës, të rinjtë e PD dhe LSI: Rama si Asad-i**

Dhjetëra të rinj të forumeve rinore të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integritet protestuan dje kundër përdorimit të gazit nga ana e Policisë së Rendit gjatë protestave të opozitës. Ata marshuan dje para Ministrisë së Brendshme duke dënuar veprimin e forcave të rendit. Të rinjtë dhe fëmijët që morën pjesë në këtë marshim mbanin kundërgaz në fytyrë, ndërsa kishin stampuar në bluzat portretin e vajzës së goditur me gaz lotsjellës, me mbishkrimin "Rama si Asad. Mos i helmo fëmijët". Protesta e heshtur e fëmijëve u mbyll para Ministrisë së Brendshme, institucionit përgjegjës për përdorimin e lëndës helmuese kundër protestave qytetare. Fëmijët lanë aty kundërgazet për t'i treguar qeverisë se në një vend normal protestuesit paqësorë, gratë dhe fëmijët nuk sulmohen me helme kimike. Gjatë protestës së datës 16 mars policia e gjendur e papërgatitur për shkak të zhvendosjes së protestës nga Kryeministria para Kuvendit u detyrua që të hedhë disa herë gaz lotsjellës, ndërsa mes protestuesve kishte edhe fëmijë.



**Zjarr dhe tym gomash në rrugë, 'Astirit' vazhdon qëndresën**

Banorët e 'Astirit' në Tiranë tashmë e kanë kthyer protestën në një ritual të përditshëm. Prej më shumë se 120 ditësh, ata mbledhen çdo mbrëmje në rrugë për të kundërshtuar projektin e "Unazës së Re". Duke kundërshtuar me forcë vijimin e projektit, ata në shenjë revolte i kërkuan edhe dje qeverisë të heqë dorë nga ky projekt, pasi, siç shprehen ata ky projekt është abuziv dhe korruptiv. Në të gjithë betejën e tyre, banorët e Astirit nuk kanë qëndruar vetëm, por kanë patur mbështetje nga opozita e bashkuar, e cila njehëresh ka kërkuar që ky projekt të anulohet një orë e më parë. Edhe gjatë ditës së djeshme ata kanë qëndruar për disa momente në rrugë, ndërsa kanë djegur goma makine në shenjë proteste kundër shurdhërisë së qeverisë.



**Basha: S'ka procedim që na ndalë, Ramës i ka filluar numërimi mbrapsht**

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka reaguar ashpër dje pas shoqërimeve të protestuesve dhe procedimit penal të Sekretarit të Përgjithshëm të PD-së, Gazmend Bardhi. Përmes një postimi në rrjetin social 'Facebook', Basha theksoi se asnjë procedim penal nuk do e ndalojë Partinë Demokratike dhe qytetarët për të përmbytur misionin për një Shqipëri, si gjithë Europa. "Asnjë procedim penal nuk e ndal Partinë Demokratike dhe qytetarët për të përmbytur misionin tonë për Shqipërinë si gjithë Europa. Përdorimi i militantëve dhe ushtarëve të kriminit në polici për të goditur qytetarët dhe kundërshtarit politik është tipari më i qartë i këtij regjimi kriminal: Edi Rama ka



ardhur në pushtet me ndihmën e bandave dhe ka zgjedhur të jetë me bandat kundër popullit", - shkroi Basha. Më tej ai shpreh bindjen se për kryeministrin Edi Rama dhe qeverinë e tij ka filluar numërimi mbrapsht, ndërkohë që theksonte se polici për të goditur qytetarët dhe kundërshtarit politik është tipari më i qartë i këtij regjimi kriminal: Edi Rama ka

rrugë do të dalin para drejtësisë! Unë dhe Partia Demokratike jemi të vendosur të mbrojmë me çdo mjet të drejtën për të protestuar, të drejtë që e fituam pas 46 vitesh të diktaturës më të përgjakshme në Europë! Numërimi mbrapsht për Edi Ramën dhe bandën në pushtet ka nisur! #ShqipëriaSiEuropa", shkruante më tej Basha në reagimin e tij.

prave penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", "Goditje për shkak të detyrës", "Kundërshtim me dhunë të punonjësit të policisë", "Prishje të rendit dhe qetësisë publike" dhe "Mbajtja dhe përdorimi i lëndëve plasëse", shtetasit: K. R., 19 vjeç, G. B., 41 vjeç, E. B., 33 vjeç, A. S., 33 vjeç; P. D.,

35 vjeç, F. RR., 40 vjeç, E. B., 31 vjeç, D. B., 22 vjeç; E. B., 37 vjeç; J. S., 21 vjeç, Q. Gj., 24 vjeç, K. K., 19 vjeç, A. B., 33 vjeç, F. Z., 20 vjeç", bën të ditur policia në deklaratën e vet. Policia thotë se po punon për identifikimin, kapjen dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë që kanë kryer veprime të dhunshme gjatë protestës së

djeshme. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme. Protesta e së shtunës ashtu si edhe disa protesta të tjera të mëparshme të opozitës u shoqërua me disa incidente ku forcave të policisë iu desh të përdorte gazin lotsjellës dhe hedhjen e ujit.

## ZGJEDHJET PROTESTA

Ish-ministrja: LSI s'ka asnjë përçarje, u çlirua nga ata që e deshën për interesa

# Gara në Tiranë, Gjoshja: Një kandidaturë e denjë përballë PS-së

## "Zgjedhjet e parakohshme të pashmangshme"

Valentina Madani

**L**SI është partia që pati më shumë 'tradhtarë' brenda opozitës pas djegies së mandateve të deputetëve. Por ish-ministrja e Integritimit Klajda Gjoshja beson se LSI nuk ka asnjë përçarje, përkundrazi sipas saj ka një çlirim nga të gjithë ata që e kanë dashur atë vetëm për interesa. Ish-deputetja e LSI-së thotë për "Gazeta Shqiptare" se opozita nuk do të ndalet në betejën e saj për rrëzimin e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie transitore, e cila do t'i hapë rrugën zgjedhjeve të barabarta. Gjoshja flet edhe për përgatitjet e opozitës për zgjedhjet lokale të 30 qershorit dhe nëse do të garojë apo jo përballë Erion Veliajt në Tiranë. Sipas Klajda Gjoshës zgjedhjet e parakohshme janë të pashmangshme për shkak të krizës politike në vend ndërkohë që ndërkombëtarëve u kujton se nuk e njohin realitetin e hidhur shqiptar.



### MANDATET

"LSI nuk ka asnjë përçarje, përkundrazi ka një çlirim nga të gjithë ata që e kanë dashur atë vetëm për interesa. Të gjithë deputetët kanë të drejtë të marrin vendimin për zgjedhjet e tyre personale. Ata do të duhet të mbajnë vetë edhe përgjegjësinë para opinionit publik dhe qytetarëve",-theksoi Klajda Gjoshja.

protestat madhështore të qytetarëve, të cilët janë në të drejtën e tyre për të vënë para përgjegjësisë qeverinë e tyre të papërgjegjshme.

**Ku e gjen forcën kryeministri Rama të jetë kaq kokëfortë në qëndrimin e tij? Çfarë do të ndodhë nëse ai nuk dorëhiqet?**

Patjetër që njeri me karriqen e kryeministrit ndjehet komod dhe me të gjitha pushtetet dhe institucionet nën drejtimin e tij. Nuk ka lider që të pranojë dështimin dhe largimin, por ai shumë shpejt do të jetë i detyruar përballë qytetarëve shqiptarë t'i hapë rrugë një Shqipërie me vizion të ri, një Shqipërie europiane!

**Pse kaq kundërshtar të huajt ndaj vendimit të opozitës për dorëzimin e mandateve? Cila është zgjidhja?**

Është e natyrshme që ndërkombëtarët të mos e kuptojnë dot realitetin e hidhur në Shqipëri sepse në vendet e tyre çdo akuzë do të gjente zgjidhjen te drejtësia. Por në një vend ku drejtësia nuk ka funksionuar kurrë, ku pan-

### LARGIMI

"Nuk ka lider që të pranojë dështimin dhe largimin, por Edi Rama shumë shpejt do të jetë i detyruar përballë qytetarëve shqiptarë t'i hapë rrugë një Shqipërie me vizion të ri, një Shqipërie europiane!",- deklaroi ish-deputetja e LSI.

gjithë deputetët kanë të drejtë të marrin vendimin për zgjedhjet e tyre personale. Ata do të duhet të mbajnë vetë edhe përgjegjësinë para opinionit publik dhe qytetarëve. Vendimi i partive politike për djegien e mandateve është një vendim politik dhe asnjë zgjedhje personale nuk e cenon dot atë.

**Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi është shprehur se zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të jenë në maj. Nga vjen kjo siguri? Për çfarë sinjalesh bëhet fjalë?**

Nuk ka rëndësi se ne cilin muaj janë zgjedhjet. Ajo çka është e sigurtë është se ato do të jenë të parakohshme.

**Çfarë do të thotë një qeveri transitore dhe sipas jush kush duhet ta drejtojë atë që vendit t'i sigurojë zgjedhje të lira?**

Qeveria transitore është ajo që mund të sigurojë zgjedhje demokratike për Shqipërinë, pa blerje vote dhe përdorim të elementeve kriminal për t'i bërë presion votuesve. Do të thotë një qeveri që të luftojë krimin dhe korrupsionit dhe të punojë për reformat shtet-



### KANDIDATËT

"Çdo individ me personalitet, integritet dhe që nuk përdor propagandën në vend të punës, do të ishte një kandidaturë e denjë. Zgjedhja e kandidaturës do t'i takojë në çdo rast strukturave të opozitës dhe dakordësisë së tyre",- theksoi zj.Gjoshja.

ndërtuese që janë kusht edhe për integritetin në BE. Është e nevojshme që qeveria tranzitore të ngjallë besim dhe të ndryshoj klimën politike në Shqipëri duke sjellë kulturën e dialogut dhe konsensusit.

**A ka nisur opozita e bashkuar bisedimet brenda saj për emrat që do të përfaqësojnë në garën e zgjedhjeve lokale?**

Nuk është çështje të zgjedhim emrat apo individët, tashmë ndodhemi në një ngërç politik, institucional dhe Kushtetues që kërkon një zgjidhje urgjente ekstra ligjore.

**Flitet se ju jeni emri që LSI po mban 'peng' në bisedimet me PD-në për sfidantit e Erion Veliajt në Tiranë..., realisht cila është e vërteta...?**

Nuk ka qenë kurrë ambicia ime dhe nuk ka pasur asnjëherë asnjë diskutim të tillë. Në këtë situatë që

ndodhet vendi besoj se kemi çështje shumë më të rëndësishme për të diskutuar. Sot diskutohet për ekzistencën e një kombi, për ruajtjen e identitetit kombëtar, për vlerat e humbura të demokracisë e për Shqipërinë e së ardhmes. Tema e emrave dhe individëve do të ishte luks në këto momente.

**Nga ana e PD-së përmenden edhe dy emra të tjerë përballë PS-së në Tiranë, Jorida Tabaku dhe Dashamir Shehi. Si i konsideroni ata dhe a mund të jetë Shehi apo Tabaku sfidantja e Veliajt në Tiranë?**

Çdo individ me personalitet, integritet dhe që nuk përdor propagandën në vend të punës, do të ishte një kandidaturë e denjë. Zgjedhja e kandidaturës do t'i takojë në çdo rast strukturave të opozitës dhe dakordësisë së tyre!

### Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e II-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Truall 310 m2 dhe ndërtesë 96 m2, me nr. pasurie 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdi Demir Tropini e regjistruar në ZVRPP Durrës.

Cmimi i ankandit të dytë është EUR 24,000 (njëzet e katër mijë euro).

Ankandi zhvillohet dt. 08/04/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë.

### SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoja", Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 02.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet 'Ankandi i I për shitjen e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5/194/1+1-0, Volumi 7, Faqe 177, Zona K.adastrale 220 në pronësi të debitorit Z.Arjan Xhevat Gjona me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email anuar.merko@gmail.com.



Së bashku më 25 aleatët e rinj që ka krijuar koalicionin, sigurohen 587 mijë vota

# Largimi i aleatëve të 2015 PS-ja humb 430 mijë vota

*Largimi i aleatëve të 2015, "drama" e lokaleve*

Nëse zgjedhjet vendore të 2015 do të përsëriteshin Partia Socialiste dhe koalicioni i saj që ka krijuar së fundmi do t'i humbiste ato. Ndaj edhe nëse zgjedhjet ardhshme vendore do të jepnin të njëjtin rezultat votash si në 2015, atëherë socialistët do të ishin humbës të tyre. Kjo pasi koalicioni që ata kanë krijuar dhe largimi i disa prej aleatëve më të fuqishëm që PS kishte në 2015, ndryshon tërësisht raportin e votave mes të majtës dhe të djathtës dhe do ta nxirrte PS-në në opozitë. Kështu nga 991 mijë vota që koalicioni i PS-së mori në 2015 për këshilltarë në rang vendi, sot së bashku me të gjitha partitë me të cilat ka krijuar koalicionin parazgjedhor, PS mban vetëm 587 mijë vota ose afro 400 mijë vota më pak. Ndërkohë që nga ana tjetër duke mbledhur votat e rreth 16 aleatëve që PS i kishte në koalicion në 2015 dhe që sot ose janë rreshtuar në koalicionin rival opozitar ose nuk kanë pranuar që të jenë në një koalicion me PS-në, rezultoni se ato i heqin koalicionit të socialistëve plotë 430 mijë vota. E në rast se këto vota ja shtojme në bllok në mënyrë matematike koalicionit të PD-së që në zgjedhjet e shkuara vendore mori mbi 500 mijë vota, atëherë me siguri që kandidatët që do të mbështeste e djathta do të dilnin fitues.



**PDS**  
Aleatja e dytë më e madhe e PS është Partia Demokracia Sociale e Paskal Milos, e cila brenda koalicionit me PS-në mundi të marrë 20 mijë vota në rang kombëtar. Partia e tretë më e madhe aleate e PS-së është PSV e Petro Koçit, e cila në 2015 ka marrë 17500 vota.

## PSD

Partia më e madhe aleate e Partisë Socialiste në koalicionin e ri rezultoi të jetë Partia Social Demokratike e Skënder Gjinushit. PSD në zgjedhjet e shkuara ndonëse konkurroi jashtë koalicioneve arriti të sigurojë 22 mijë vota.

## PS, ikin 16 aleatë, mes tyre LSI, PDIU, FRD e PDK

Partia Socialiste, në raport me 2015, ka humbur thuajse të gjithë aleatët e saj me pesë në elektorat. Ajo ka humbur mbështetjen e thuajse 16 partive që në 2015 i kishte në koalicion, por sikur të mos mjaftonte vetëm kjo, shumica e partive që janë larguar nga koalicioni kanë një mbështetje të konsiderueshme të votuesit. Në total të 16 partitë që janë larguar nga koalicioni me PS-në në 2015 kanë arritur të marrin si votë për këshilltarë plotë 435 mijë vota, ose afro 30 mijë vota më shumë se sa ka marrë PS e vetme. Natyrisht që aleati kryesor që ajo ka humbur është Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila në zgjedhjet e 2015 arriti të sigurojë një nga rezultatet e saj më të mira. Ajo arriti të marrë rreth 260 mijë vota dhe duke rivalizuar edhe dy partitë



kryesore, pra PS dhe PD. Një tjetër aleat me pesë që i është larguar kësaj here socialistëve është e Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet e Shpëtim Idrizit. Në zgjedhjet e shkuara ajo mori afro 60 mijë vota dhe duke dhënë një ndihmesë të konsiderueshme koalicionit në fitoren e shumë bashkive. Forca e tretë që i largohet PS-së nga koalicioni në këto zgjedhje është edhe Fryma e Re Demokratike. Ndonëse deri më tani ajo nuk

është shprehur publikisht për këtë gjë, FRD e Bamir Topit nuk ishte në listën e partive që firmosën javën e shkuar koalicionin me PS-në. FRD në zgjedhjet e shkuara vendore arriti të marrë 30 mijë vota. Një tjetër parti e vjetër tashmë dhe me një elektorat të saj të konsoliduar është edhe Partia Demokristiane e Nard Ndoqës. Në zgjedhjet e shkuar PDK mori plotë 20 mijë vota dhe duke dhënë një ndihmesë në bashkitë me përqendrim të popullsisë katolike, si Shkodra, Vau i Dejës apo Lezha. Ramën në këto zgjedhje duket se e ka "tradhtuar" edhe PDL e Spartak Ngjelës. As partia e tij nuk ishte në partitë që firmosën marrëveshjen deklaratorë dhe përbashkët një javë më parë. PDL në zgjedhjet e shkuara mori afro 8 mijë vota.

### VOTAT QË KANË MARRË NË 2015 PARTITË NË KOALICIONIN ME PS

- PS - 402709 vota
- PSD - 22320 vota
- PDS - 20271 vota
- PSV - 17465 vota
- PSM - 15355 vota
- PAD - 11392 vota
- PGJ - 10221 vota
- PUK - 10078 vota
- ADS - 9008 vota
- PASH - 7314 vota
- PMDE - 4813 vota
- PSP - 4622 vota
- PRD - 3957 vota
- PDM - 3443 vota
- ABDE - 3271 vota
- PPSH - 2795 vota
- PK - 8 Nëntori - 969 vota
- PKD - 9424 vota
- PCCSH - 2463 vota
- PDRE - 5521 vota
- PLDSH - 4664 vota
- PAP - 1712 vota
- PFM - 717 vota
- Në total koalicioni - 587038 vota**

### PARTITË QË LARGOHEN NGA KOALICIONI I 2015

- LSI - 259934 vota
- PDIU - 59701 vota
- FRD - 29984 vota
- PDK - 20271 vota
- Aleanca Arbnore - 12647 vota**
- PLD - 8607 vota
- PRRL - 3919 vota
- PFR - 5947 vota
- PSHA - 5162 vota
- PLDN - 3990 vota
- PEI - 3759 vota
- PBMSH - 2676 vota
- PADSH - 7953 vota
- PPAK - 7132 vota
- PKSH - 4077 vota
- Në total - 435822 vota**

**KOALICIONI I RI**  
Partia Socialiste shpalli pak ditë më parë një koalicion të ri parazgjedhor. Në total veç PS-së pjesë e tij ishin edhe 25 parti të tjera, shumica dermuese aleate të PS-së edhe në zgjedhjet e shkuara vendore. Ndërkohë që disa prej tyre të ardhura rishtazi, si PSD e Skënder Gjinushit, apo edhe partia MEGA e minoritetit grek. Por siç rezultoi të gjitha partitë që PS ka bërë pjesë e këtij koalicioni kanë një mbështetje të vogël elektorale në krahasim me mbështetjen që kanë partitë që nuk do jenë më pjesë e koalicionit me socialistët. Kështu në total të 25 partitë aleate të PS-së në zgjedhjet e shkuara vendore, morën 184 mijë vota për këshilltarë, e cila në zgjedhjet vendore është vota për partinë. Ndërkohë që PS në ato zgjedhje mori vetëm 402 mijë vota si forcë dhe në total bashkë me aleatët e rinj ajo ka vetëm 587 mijë vota. Natyrisht duhet theksuar se vota për këshilltarë nuk është treguesi më i mirë për mbështetjen

që kanë subjektet politike, kjo pasi në shumë rastet votat e partive të vogla janë vota të dhuruara nga partia kryesore, si shpërblim për votën që ato i japin kandidatit për kryetar bashkie. Gjithsesi si koalicion mund të thuhet se vota për subjektet është një tregues i mirë për të parë mbështetjen që ka një krah politik.

### VOTAT

Partia më e madhe aleate e Partisë Socialiste në koalicionin e ri rezultoi të jetë Partia

Social Demokratike e Skënder Gjinushit. PSD në zgjedhjet e shkuara ndonëse konkurroi jashtë koalicioneve arriti të sigurojë 22 mijë vota. Pas saj vjen Partia Demokracia Sociale e Paskal Milos, e cila brenda koalicionit me PS-në mundi të marrë 20 mijë vota në rang kombëtar. Partia e tretë më e madhe aleate e PS-së është PSV e Petro Koçit, e cila në 2015 ka marrë 17500 vota. Pas saj vjen Partia Socialiste e Moderuar e Gjergji

Kojës, e cila ka marrë 15 mijë vota. Partia e katërt më e madhe në aleancë me PS-në është Aleanca Demokratike me 11 mijë vota, Partia e Gjelbër dhe Partia Unitetit Kombëtar me nga 10 mijë vota. Të gjitha partitë e tjera që kanë firmosur për të qenë pjesë e koalicionit me PS-në kanë marrë më pak se 10 mijë vota. Partia me më pak vota është Partia Fronti i Majtë me 700 vota dhe Partia Komuniste - 8 Nëntori me 969 vota.

Autori ende në kërkim. Policia: Dyshohen borxhe të vjetra

# Vrasja te liqeni, pranga mikut të Haxhi Baxhinofskit

## Zbardhet dëshmia e Pashës: Si ndodhi konflikti

Identifikohen autorët e vrasjes së 62-vjeçarit nga Fieri, i cili u vra te kodrat e liqenit mbrëmjen e së shtunës. Policia thotë se ka arrestuar mikun e Haxhi Baxhinofskit, viktimë e atentatit për moskallëzim krimi. Ngjarja e rëndë ndodhi kur at e bir dilnin për ecje te liqeni artificial në Tiranë, ndërsa një i ri i maskuar qëllon ndaj tyre. 62 -vjeçari i dënuar politik gjeti vdekjen ndërsa shpëtoi djali i tij. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur si pasojë e një konflikti të hershëm, i cili pritet të sqarohet nga momenti në moment. Në pranga ka rënë Myftar Pasha, 56-vjeç, i cili akuzohet për moskallëzim krimi.

### NGJARJA

62-vjeçari Bacinovski e kishte rutinë të përditshme ecjen nga liqeni i pasditeve me të birin. Autori e ka pritur tek liqeni derisa ai ka mbërritur dhe më pas e ka ekzekutuar dhe është larguar në këmbë nga vendngjarja. Ai është qëlluar me pesë plumba, ndërsa në ato momente trupi është batur dhe ka rënë në shkurret poshtë pistës së vrapit. Viktima ka qenë i veshur me tuta sportive, në ngjyrë të zezë. Dyshohet se vrasja ka ndodhur si shkak i një borxhi që vrasësi i kishte viktimës. Familjarët e viktimës pretendojnë se autorët u detyrohen një shumë të mëdha parash. Vite me parë viktima Haxhiu i kishte dhënë një shumë parash babait të autorëve, dhe tani ua kërkon të bijve duke i kërcënuar.

### MIKU I VIKTIMËS

Sipas dëshmisë së mikut të Myrtajt, 62-vjeçari që mbeti i vdekur tek 'Liqeni Artificial' sapo kishte parë autorin e dyshuar të vrasjes, i është afruar duke e ofenduar, ndërsa më pas, kjo skenë ka degjenuar në përleshje fizike dhe sipas Myftar Pashës, pas këtij veprimi, miku i tij ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar drejt 62-vjeçarit. Ai tha para policisë se nuk e dinte se miku i tij kishte armë me vete, ndërsa shtoi se ngjarja e rëndë ka ndodhur në një kohë shumë të shpejtë. "Islam Myrtajn e kam shok dhe komshi. Të shtunën pasdite më mori në telefon më pyeti ku je. I thashë po dal nga liqeni dhe ai erdhi më shoqëroi. Ishim duke ecur te dy kur përballë pamë Haxhi Baxhinofskin me të birin. Isla-



Kush ishte viktima që u vra mbrëmjen e së shtunës te kodrat e liqenit në Tiranë

Haxhi Baxhinovski ishte një ish-i përndjekur, i dënuar dy herë në regjimin komunist. Ai lindi më 2 korrik të vitit 1957, në fshatin Radostinë të Fierit. Më 30 janar 1982, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për "agjitacion e propagandë".

Ai u dënua sërish më 3 qershor 1984, kësaj radhe me 21 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për "veprën e terrorit në bashkëpunim" (dënim i kombinuar). Haxhi Shefqet Baxhinovski ka qenë i dënuar në kampin e Qafës së Barit, madje ka marrë pjesë edhe në revoltën e Qafës-Barit.



## Tiranë/ Tentoi ta vriste të riun, zbardhet ngjarja e 14 marsit

Policia ka zbardhur ngjarjen e ndodhur në mbrëmjen e 14 marsit 2019 në rrugën "Prokop Mima", ku mbeti i plagosur me armë zjarri, Enea Teqja, 29 vjeç. Autori është identifikuar ndërsa vijon puna për kapjen e tij.

"Zbardhet ngjarja e ndodhur mbrëmjen e 14 marsit 2019, ku në rrugën "Prokop Mima" u plagos në këmbë me armë zjarri shtetasin E. K., 29 vjeç. Policia identifikon dhe shpall në kërkim autorin. Procedohet penalisht dhe një 26-vjeçar për "Deklaratë të rremë para oficerit të policisë gjyqësore". Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës në DVP Tiranë, identifikuan dhe shpallën në kërkim shtetasin: A. B., 30 vjeç, banues në Tiranë. Mbrëmjen e 14 marsit 2019, ky shtetas në rrugën "Prokop Mima", ka tentuar të vrasë me armë zjarri, shtetasin E. K., 29 vjeç, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Gjithashtu, u procedua në gjendje të lirë shtetasin H. I., 26 vjeç, banues në Fushë-Krujë, pasi ka dhënë deklarinë të rremë përpara oficerit të Policisë Gjyqësore. Materialet u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprime të mëtejshme", njofton policia.



mi me tha "boo kush duron këtë, do më kujtojë lekët". Kur Haxhiu u afrua e ofendoj Islamin rëndë dhe e goditi. U përleshën të 2 dhe pastaj Islami nxori pistoletën dhe qëllon 4 ose 5 herë. Sapo qëllon, Islami u drejtua drejt kodrës. Ndodhi shumë shpejt. Unë nuk

kisha dijeni që Islami kishte armë dhe që do e vriste. U tremba shumë dhe shkoja direkt në shtëpi. Sot u qetësua dhe mora kontakt me policinë", tha ai. Policia ndërkohë vijon punën për kapjen e autorit, i cili u largua mbrëmë nga vendngjarja.

Tirana International Airport  
Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

TENDER OPPORTUNITY FOR TAXI SERVICE BUSINESS at  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Experience of provision and installation of taxi services (not necessarily service for airport). Please note at least 1 year of experience is necessary.
- Taxi license of the company related to the subject of the concession (any company which fails to meet the above criteria will not be taken into consideration).
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas, only on 19 March 2019 up to 15:00 Eastern Time.

Only to the companies that will submit a formal request for participation will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or to all the following email address:

#### Tirana International Airport Nënë Tereza SH.P.K

Administration Building  
Commercial & Property Department  
Rinas, Albania

Emails:  
Commercial Department Alisa Gjinari [agjinari@tirana-airport.com](mailto:agjinari@tirana-airport.com)

Legal Department Ilir Alimema [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)

Procurement Department Albi Palushi [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

Tirana International Airport SHPK  
Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
Phone: 0355 4 2381 600 Fax: 0355 4 2381 545  
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com







## SOCIALE

'TUNGJATJETA JETE'/ Në një prej zonave më të varfra të vendit aktivistë në krah të familjeve me fëmijë të sëmurë



Laureli dhe Mimoza



Eva dhe Laureli

# Buzëqeshja, "magjia" që shëron

Fatos Baxhaku

Në fillim është një lapidar, një yll i madh, i lyer me gëlqere, që përkujton një betejë që është bërë në këto anë në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Një tabelë në anë të rrugës na e kujton edhe më mirë se ku po shkojmë. Ajo shënon Pishkash.

Është një ditë pranvere, plot diell. Bashkë me ne udhëtojnë edhe Eva Buzra dhe Mimoza Polisi, vajza të reja. E para ka një zanat fort të vyer, është logopede, me një fjalë u mëson të pamundurve se si mendimet e tyre t'i hedhin në fjalë, një gjë që të kujton diçka nga njerëzit e fesë dhe misioni i tyre. E dyta është psikologe, edhe kjo një punë fort e dobishme në kohë egoizmi e inatsh.

Ndërsa makina 4X4 capitet në xhadenë e vjetër e të dëmtuar, vajzat janë kreyt të hareshme, do takojnë pacientët e tyre të vegjël. Të dyja janë aktivistë të projektit 'Tungjatjeta Jete' të World Vision, një projekt që ka nisur afër një vit më parë. Bashkitë Përrenjas dhe Librazhd kanë një numër të lartë fëmijësh të pamundur, autizëm, sëmundje të trashëguara që nga lindja, kanë mbërthyer shumë fëmijë në shtëpi dhe, sigurisht bashkë ta edhe prindërit e tyre. Një fëmijë me problem të rënda është një telash i rëndë për secilin familje, por në këto anë, hallit i shtohet edhe varfëria. Deri në vitet '90 e ca më pas, vendasit jetonin me minierën e Pishkashit, por kur ajo u mbyll burrat e këtyre anëve nuk ishin më as fshatarë dhe as minatorë, ishin thjesht të varfër dhe, shumë herë, të harruar në fatin e tyre. Puna kryesore tani është të jesh

çoban sezonal në Greqi. Krahina ka pak tokë të punëshme dhe blegtoria e paktë është sa për të mbajtur frymën gjallë.

Eva dhe Moza na thonë se, bashkë me kolegët e tyre, kanë nën mbikëqyrje, 41 fëmijë në dy bashki që kanë një shtrirje të gjerë, ndër zona malore, shumë herë ndër shtëpi e fshatra ku është vështirë të mbërrish edhe në mijëvjeçarin e tretë. Deri më tani askush nuk ka ditur të shpjegojë shkencërisht numrin shumë të lartë të fëmijëve të pamundur në raport me numrin e popullsisë në këto anë. Ca nga buzëqeshja e vajzave, ca nga që bagazhin e makinës ato e kanë stërbushur me lodra shumëngjyrëshe, dhe ca nga që dielli i pranverës së parë ka nisur të shkëlqejë mbi dheun e kuq - shenjë e hekurit - në këto anë, udhëtimin na duket sikur e bëjmë vetëm për pak minuta.

Laurel Polisi, 9 vjeç duket i lumturuar kur në shtëpinë e tij hyjnë dy vajzat me tuftën e lodrave. Duket sheshit se marrëdhëniet mes tyre tashmë janë bërë një burim shprese edhe për prindërit e Laurelit. Djali është diagnostikuar me autizëm. Rrëfen Shpresa, e ëma: "Andej nga viti i tretë i jetës, djali na bëri merak. Kishte problem me ushqimin. Nuk po arrinte të fliste. Bashkë me tim shoq vrapuam në Librazhd. Doktorët atje na çuan në Tiranë. Këtu na thanë se çfarë problemi të rëndë kishte. As që ia kishim idenë se çfarë ishte autizmi dhe në fillim e humbëm shpresën, por pastaj erdhën vajzat e 'Tungjatjeta' dhe tani ka raste që as edhe vetë nuk u besoj syve. Djali, brenda një vit ka pasur përmirësime të mëdha...". Babai i Aurelit, sapo është



Në familjen e Emanuelit

kthyer nga Greqia ku punon sa herë gjen punë. "Unë, ngaqë e rri disa kohë pa e parë - na thotë - e kam edhe më të qartë përmirësimin. Kujt ia prishte mendja se djali do të shkonte në shkollë në Përrenjas, në klasë të parë vërtet, por ama në mënyrën e tij ai tani ka shokë, atje e duan, e quajnë njërin prej tyre, sado që ky i yni nuk flet, por ama sytë i shndrisin sa herë e motra e bën gati për t'u nisur për në shkollë. Tani ka mësuar edhe ushtrimet e para të shkrimit, bashkon pika, shënon viza. Kujt ia prishte mendja!?" Babai këmbëngul që të shënojmë edhe një gjë të fundit në blloqet tona. "Kjo gjë nuk do të ndodhte sikur të mos ekzistonte mirësia. Eva dhe Moza ma kanë ndryshuar djalin. Po ashtu edhe mësuesit dhe nxënësit atje poshtë në Përrenjas. Po të mos ishte kjo mirësi, këto buzëqeshje që sheh sot te ne apo te djali, nuk do t'i kishit parë dot...". Biseda me prindërit zhvillohet teksa vajzat vazhdojnë me durim të kryejnë terapinë e tyre, ndërsa në ndërkohe mësojmë të reja të tjera mbi përmirësimin e Laure-

*Një ditë me njerëzit që përballen me dhimbjen mes varfërisë*

lit. Ai tani arrin që të përqendrohet përballë televizorit sa herë që ka filma vizatimorë. Madje ka shkuar aq larg sa të ketë edhe këngëtaresh e tij të preferuar, një vlonjate që këndon këngë folk. Prindërit e quajnë fitore të madhe faktin që ai tani arrin të marrë vetë shishen e ujit, një gjë që nuk e dinte një vit më parë. Eva dhe Moza e kanë mbaruar terapinë, na duhet të përsëritemi. Laureli i vogël, qëndron një copë herë te pragu i derës, teksa vajzat vazhdojnë të ngjiten drejt një rrëpire që të çon në xhade. Do të kishte dashur që ato të qëndronin edhe ca në shtëpinë e tij.

Dielli ka nisur të ulet dhe nga lugina e Shkumbinit ka filluar të fryjë një erë e thellimtë. Po shkojmë drejt fshatit Babje, në të dalë të Librazhdit. Evën dhe Mozën i shikojmë më të shqetësuar. "Ky rast, ku po shikojmë tani, është i vështirë, vërtet i vështirë", na thotë njëra prej tyre si për të na

përgatitur. Brenda pak minutash jemi në familjen Muraçi. Këtu jetojnë tre vetë, mamaja, Emanueli, 6-vjeçar, dhe e motra dy vjet më e vogël. Babai është në emigracion. Punon çoban në Greqi. Emanueli është autist, që ekspertet tona e vlerësojnë si të shkallës së mesme. Në kuzhinën e thjeshtë, të ngrohur mirë nga soba me dronë, në fillim mbizotëron heshtja, më pas dëgjohe vetëm komunikimi i vajzave me Emanuelin, pastaj një potere dhe zëri i mekur i së emës që mundohet të qetësojë djalin. Kuptohet qartë se dikush ka gabuar. Jemi me vetë, me aparatet, me blloqet, me stilolapsat, mbase me vetë qëndrimin tonë, që kemi ndërhyrë befaz në botën e thellimtë. Po shkojmë drejt fshatit Babje, në të dalë të Librazhdit. Evën dhe Mozën i shikojmë më të shqetësuar. "Ky rast, ku po shikojmë tani, është i vështirë, vërtet i vështirë", na thotë njëra prej tyre si për të na

kohë boll kështu që, duke na bërë përshtypje, godina kreyt e veçantë, ku jeton familja Muraçi e Babjes, shfletojmë në një libër që kemi me vete. Godina në të vërtetë duket sikur vjen nga një kohë tjetër, fort e largët. Ja përse: "Në Librazhd - lexojmë në librin e Shaban Gjurës, Librazhdi dhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare - italianët, që para pushtimit, por edhe më pas, kishin krijuar infrastrukturën e duhur për instalimin e ushtrisë. Ishin ndërtaur kazerma ushtarake në Babje... Kjo periudhë është si të thuash një 'çudi historike', pasi pushtimi italian në zonat rurale të trevës sonë duket i largët. Repartet ushtarake italiane në Librazhd, në vitet 1939-1940, shërbenin më shumë si reparte pune, e bashkë me to punonin me dhjetëra punëtorë të zonave përreth. Midis ushtarëve italianë e popullsisë vendase zhvilloheshin marrëdhënie këmbimi mallrash, bëheshin tregti. Buka dhe makaronat italiane, ishin të preferuara nga fshatrat përreth, të cilat i këmbenin me produkte natyrore të zonës...".

Dy protagonistet tona, kanë dalë në oborrin e ish-kazermës së vjetër, kështu që na duhet të shkëputemi nga kujtimet e atij "pushtimi të butë". Janë të shqetësuar vërtet, porse kreytësisht të bindura se edhe në rastin e vështirë të Emanuelit, do arrijnë të kenë të njëjtin sukses që kanë arritur në rastet e tjera. Na duhet të ndahemi edhe me to. I presin punë të tjera. Në kthim bashkë me ne, mbi kroskot, ndër blloqe, ndër aparate udhëton bashkë me buzëqeshja e tyre e madhe, buzëqeshja që jo vetëm shëron, por i bën njerëzit të mëre.

(Ky reportazh u mundësua nga World Vision, Albania & Kossovo).

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohe në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

**KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK**  
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

# Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

## Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

### LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerësimit të tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Llambi Kotoko		2500
Korçë	Ilmi Calo		10500
Korçë			18775
Shkodër	Lezina Kiri	177	525
Tiranë	TRASHËGIMTARËT I KASHGJITAKET	500	9716
Tiranë	NEBI SEFA	90	260
Tiranë	MEHMET MACI	400	1200
Korçë		225	2485
Durrës	Masar Shaba	5000	1800
Durrës	Alush Meta	4000	6000
Durrës	Aleksandër Piqoni	5000	65000
Qarku	Emri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e	Sipërfaqe e
Tiranë	HASAN BAHUSHI	243	229.5
Tiranë	Shaban Pinari	5960	4738
Korçë	Petrit Kutrolli	575	825
Korçë	Reshat Beqir		930
Tiranë	Spiro Avrami	264	408
Vlorë	Angjeliq Baguca	1537	800
Vlorë	Ardia Lezo	410	977
Vlorë	Polikseni Ceko	730	450
Vlorë	Myftar Cuci		1050
Vlorë	Spiro Qirjaqi	2600	550
Elbasan	Sulo Lila		1189
Elbasan	Dituri Xhangolli		3137
Elbasan	BEHAR CONIKU		2390
Elbasan	SHYQO TOCILA		2660
Gjirokastrë	Ilijar Kokalari	12660	3840
Tiranë	MUHAMET FISHKU	3486	514
Elbasan	Avram Vangjel Biqiku		0
Korçë	Sejat Berberi	170	830
Korçë	ZYDI TOPI	1806	1450
Korçë			420
Vlorë	trashëgimtarët	241.4	944.5
Vlorë	Minella Bala	1098	3180
Berat	Nexhmedin Shehu	400	2600
Korçë	ZYMBYLE AGOLLI	1386	1378
Korçë	Lefter Tili		1690
Korçë	Qirjako Kolaci		1000
Korçë	Samedin Kulla		2917
Korçë	Shyqyri Terolli		7898

Qarku	Emri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Nikolla Naço	5000	2387
Tiranë	BASHKIM VORPSI	3248	6277
Fier	Bilbil Serjani	900	1860
Fier	Muharrem Hodaj	8830	10090
Korçë	Rapo Hoxhalli		1073
Korçë	Hysen Berberi		2400
Tiranë	NEXHIBE TARAKU	224	842
Fier	Haredin Hamitaj	384	750
Fier	Nebi Kapaj		10400
Tiranë	NDREKO QIRKOLLARI		100
Durrës	Aleksandër Tirana		0
Durrës	Agim Beshiri	423	1272
Durrës	Liman Sheqerja		228
Durrës	Thoma Nisi		8557
Durrës	KISMA KATONKE DURES KISMA KATALIKA DURESE		9134
Durrës	Isa Shuaipi		320
Korçë	Petro Popllo	3640	140
Kukës	Halim Nobolli		8032
Tiranë	NIKOLLA KATRO		3904
Lezhë	Pjeter Llesh Haci	1300	4134
Durrës	Mustafa Kalavrezi		217.5
Durrës	Mustafa Kalavrezi	9072	453.3
Durrës	Haki Doraci, Hysni Doraci	5000	0
Durrës	Haxhi Vogli		6790
Elbasan	Livan Murati		2834
Elbasan	Ferik Cela		4798
Fier	Ramadan Troka		10300
Fier	Jemin Milova	10000	1000
Fier	Rushan Rushani	500	10100
Fier	Viçe Samargjiu		10425
Korçë	VIKA LAKRORI	150	600
Tiranë	AHMET MESITI		303
Vlorë	Kristina Kaliopi, Lipi Prifti		600
Vlorë	Miti Nushi	860	140
Qarku	Emri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e	Sipërfaqe e
Vlorë	Perlat Lushaj		1950
Dibër	Fitie Deda		0
Dibër	XHAFER SELIM GJOKA		2926
Gjirokastrë	Asllan Kaci (Dabaj)	206	1462

Lezhë	Gjin Preng Leka		0	Fier	Agim Nezha		10136
Lezhë	Dilaver Shafloqi		0	Fier	Avni Delvina		7230
Lezhë	Pashk Trokthi		0	Fier	Hysen Dervishi		10000
Tiranë	GRIGOR JANI GJIRJA		48	Fier	Vasil Beqiri	5000	15880
Tiranë	LUMTURI BALLA		3700	Korçë	MAZLLEM SLOGU	1145	1655
Tiranë	FIQIRI SINELLA		10830	Korçë	Nexhat Karameta	1961	2075
Korçë	Llambi Napuce	594	895.5	Korçë	Shkelqim Karameta	3355	1665
Korçë	Viktor Skendi	339	1564.2	Korçë	Ilias Karameta	1625	2570
Korçë	Osman Thellimi	5000	6250	Korçë		500	0
Tiranë	BEQIR DERHEMI		11204.5	Tiranë	Ana Xhumari		375
Tiranë	BEQIR DERHEMI		11204.5	Korçë	Ali Petriti		3380
Korçë	Kozma Tane		116.6	Fier	Arben Banie	5000	10180
Durrës	Namik Mane		418.7	Fier	Dervish Baraj		10000
Durrës	Sadush Hidri	132	2698	Korçë	Dhori Kolemiço		6200
Lezhë	Zef Mark Reci	50	10795	Korçë	Dajlan Selmani		4308
Dibër	Qamil Bala		125	Fier	Xhemal Bandaj	2420	280
Dibër	Qamil Bala		2798	Tiranë	SHABAN SHIJAKU	2841	1733.5
Durrës		543	3082				
Gjirokastër	Sali Saliq	2960	3115		<b>Qarku Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Gjirokastër	Bujar Fezga	110.5	59.1	Tiranë	Figiret Dervishi		1695
Gjirokastër	Ermion Caci		4806	Korçë	Miti Çeço	1200	1616
Gjirokastër	Bardhyl Memishaj	455	1587	Tiranë	EDUARD BANJA		28.4
Tiranë	QERIME SHABANAGA	5930	0	Fier	Kujtim Brahimi		5500
Dibër	Isuf Llorja		0	Korçë	Agim Çollaku	702	140
Gjirokastër	Qako Konini	874	206	Tiranë	MUSTAFA EMIRI	468.6	84
Elbasan	SADIK KALA		2280	Tiranë	TOMORR CAMI	2401.5	3093
				Elbasan	KUJTIM HARUNI		2115
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	Korçë		3190	310
Elbasan	Halit Jança		1856	Tiranë	AFERDITA TAJFAJ	1066	0
Korçë	HYSEN SINO	1450	500	Lezhë	Gjok Luca		585
Kukës	Sadik Adem Maçi		23081	Lezhë	Skender Kasmi	465	2310
Shkodër	Feride Rukaj	1400	1018	Elbasan	MURAT HAKA		0
Durrës	Hasan Gega	1326	230	Korçë	Feride Gjyli	205	0
Durrës	Hajdar Gega	200	1000	Korçë	Feride Gjyli		3000
Durrës	Levzot Duma		4350	Tiranë	XHEMAL BOKA	3050	7210
Durrës	Demir Kapllani		140	Tiranë	LATIF XHAJA	4573	3027
Korçë	Pellumb Hoxha	1014	611	Dibër	HASAM DEDOLLI		3264
Korçë	Shaban Shaholli		2064	Korçë	Pandi Petro		401
Korçë	Josif Plaku	3400	569	Korçë	Guradem Ropi		2070
Korçë	JOSIF MUSTAFA		207	Korçë	Myfit Guxholli		11051
Tiranë	Spiro Avrami	264	413	Korçë	Ollga Llazari		2600
Vlorë	Jani Papa	8376	31448	Korçë	Fidarije Babani	1050	2755
Vlorë	Petrit Golemi	2800	5000	Korçë	Resmie Binjaku	182	1777
Vlorë	Petro Naci		793	Tiranë		1044	638
Vlorë	Kamo Sheremeti		1944	Durrës			275
Durrës	Komuniteti Bektashian	15500	261183	Durrës	Aleksander Angari		300
Korçë	ZEQIR KUTROLLI	676.5	600	Durrës	Justina Tedeskini	5000	1300
Korçë	Besnik Zegullaj		86	Durrës			257.5
Kukës	Rabie Alia		12916				
Tiranë	AGIM KACIU	304.5	195.1	<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Vlorë	Lavdosha Muka	3092	1200	Durrës	Çezar Goga		9950
Vlorë	Hiqmet Memetaj	2796	7312	Elbasan	MEHMET DHE MUSTAFA CANI	10000	0
Vlorë	Baxhul Agaj		600	Shkodër	Kalec Ashiku		9800
Vlorë	Dafina Buca	2635	1865	Shkodër	Ferit, Samir, Myzati, vjona dhe Hiamat Vasio	4000	6260
Kukës	Mehmet Meshi		11169	Shkodër	Zef Nika		3000
Vlorë	Shane Dulla		3100	Dibër	SABRI BAJRAM KETA		5609
Elbasan	DILAVER HOXHA		2800	Korçë	Vllazëria Çollaku	2542	5891
				Shkodër	Seladin Lici	497	783
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	Shkodër	Rasim Ceni	224	226
Elbasan	KUJTIM CINIKU		732	Shkodër	Latif Mustafa	3355	2722
Elbasan	SHEFQET ALLKA		4363	Durrës	Skënder Isaku	576.95	507.4
Elbasan	Gani Allka		2225	Elbasan	BUKURIE DEMIRI		4125
Elbasan	PETRIT ALLKA		612	Fier	Llazi Gjeci	10000	3140
Elbasan	MEHMET, ETJ QORRI		8000	Fier	trashëgimtarët		0
Elbasan	DYLAVERE BISHANI		5000	Fier	Kristo Mone	400	10200
Elbasan	HENERIETA KUNGULLI		161660	Korçë		273	2269
Elbasan	ASLLAN HAXHIASLLANI		660	Korçë	Seit Zorba		250
Fier		2600	0	Kukës	Hajrie Muça		0
Fier	Rapo Agaj	2040	4260	Vlorë	Eftidhia, Lefteria, Zoto	280	360
Fier	Neshat Agaçi		0	Gjirokastër	Fadrin Bilimani	945	674

Gjirokastër	Servet Myrtolli	532	3818
Gjirokastër	Kristo Foto		1098
Korçë	Ilia Grazhdani	837	225
Shkodër	Gjergj Pjeter Duka	1000	10891
Tiranë	RAKIP VORPSI	2697	4194
Shkodër	Ndue Luk Veshnja		10500
Gjirokastër	Komiteti Mysman Bektasman Bektas	5390	600
Fier	Mystehak Levanaj		8440
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Fier	Ferit Ymeraj		3900
Tiranë	Agron Shteti, Besnik Shteti, Hysen Shehu, Shemsi Shehu, Xhezaile	860	3463
Tiranë	ZENUN MASHA	675	9539.5
Tiranë	BASHKIM XHAFA		735
Tiranë	SABAUDIN GRAZHDANI		500
Tiranë	Ethem Gjuzi		4000
Tiranë	Dylbere Sulejmani	107	63
Korçë	Ligor Gjoka		1360
Korçë	Enver Zekollari		2336
Korçë	Boris Velo	370	152
Korçë			3000
Korçë	Reko Hodo, Remzi Hodo		995
Korçë	Maksi Kyçyku		5673
Durrës	Fatmir Beja		3150
Durrës	Hysen Tivari		1180
Shkodër	Bardhok Prek Suti		2782
Shkodër	Kadri Halili	308	10176
Shkodër	Mark Prend Gjoni		2283
Shkodër	Osman Daut Kadija	1000	350
Tiranë	SADETE ZHEGU	784	963
Elbasan	ENRIK TAFANI		0
Elbasan	RAMAZAN KOKONOZI	5000	8810
Fier	Petro Tanaka	10000	3500
Fier	Myfit Shehaj	1380	9920
Elbasan	Kareman Braçi	5000	5806
Lezhë	Shuke Tuk Shtjefni		0
Lezhë	Preng Zef Tuci		4001
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Tiranë	SABRIE ALI ALI	995	758
Tiranë	ISLAM DERHEMI	9800	12750
Vlorë	Jolanda Tetova		680
Vlorë	Shpresa Elezi		1300
Vlorë	Qemal Copi		1200
Vlorë	Nasho Qirko, Telemak Qirko	450	4700
Korçë	Violeta Karamuçja		1600
Shkodër	Zyhdj Zhabjaku		925
Durrës	Mustafa Rexha		121.75
Durrës	Eleni Nushi		3728
Durrës	Panajot Panajoti		3501
Durrës	Luçian Gjinaj		1180
Durrës	Fisnik Dibra		1180
Durrës	Vilson Martika		400
Durrës			2503.25
Elbasan	ALI KOKONOZI	1750	12275
Fier	Stavri Gjini		0
Fier	Gjergj Gjini		6800
Tiranë	REFIK KAPIDANI	400	11835
Tiranë	ARSINAI KERRUSI (LASKU)		0
Gjirokastër	Niko Mano		4055
Elbasan	RESHIT HOXHA	5000	1300
Kukës	Ismail Sahajani		8395
Tiranë	AGIM BEJA	4774	3613
Tiranë	XHEZAIR IDRIZI	142	689
Shkodër	Xhevdet Myftia	3060	2940
Gjirokastër	Vangjel Nakuci	2870	6701
Korçë	Kristaq Palo	169	1231
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Tiranë		446	312
Durrës	Panajot Pasku		240

Durrës	Petrit Selimi		700
Durrës	Hajrie Kalesha		1180
Durrës	Gjergj Qeraxhia		1180
Durrës	Nehat Tërshana		1180
Durrës	Fotini Beshiri		10400
Durrës	Fatos Rama		1180
Korçë	Mehmet Aliolli		2200
Korçë	Sofika Nasi	294	1240
Kukës	T rasgumtarec Kojgeci	4973	6465
Vlorë	Teuchinstarec Kaloshi		1300
Vlorë	Fatmir,Jonuz Kucuku		1300
Korçë	Sokol Kulla	1092.5	7777.5
Durrës	Areti Leka		2580
Lezhë	Nikolin Gega		0
Lezhë	Nikolle Llesh Gjergji	3515	3500
Shkodër	Esma Boksi	72	124
Elbasan	ADEM TAFI		2881
Elbasan	Zenun Zogu		3076
Shkodër	Hilmi Kamata	5000	5200
Fier	Aristir Kulari	706	2124
Berat	Hetem Hodo		5350
Korçë	Dhimiter Peço		4500
Shkodër	Bardhyl Cungu		630
Shkodër	Hysen Bushati	19800	0
Tiranë	Visne Xherani, Feride Xherani, Haxhio Xherani		465
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Tiranë	SKENDER KERÇIKU	8164	11568.6
Tiranë	KASEM TAFI	1865	0
Tiranë	LUTFIDE , FATIME MAZREKU, BEJA	66	149
Shkodër	Bardhosh Cungu	8500	1750
Fier	Cano Muhametaj	1198	1160
Gjirokastër	Agron Vishe	1736	25856
Tiranë	MIRANDA HAVERI	108	0
Gjirokastër	Aferdita Xhitomi	5818	1282
Durrës		207	25
Durrës	Filip Kuçi		400
Durrës	Kujtim Arkaxhiu		1180
Durrës	Arap Toska		95
Durrës	Filip Leka		1767
Durrës	Zyra Shengjergji	15895	5199
Durrës	Sherif Shquti		1350
Durrës	Kujtim Halili		25140
Korçë	Mazlleni Bylyku		0
Tiranë	Jakup Kokonozi		14000
Vlorë	Lilo Toska		1300
Korçë	Naço Shkurti		880
Kukës	Miftar Meshi		18481
Tiranë	Kujtim Sinella		640
Tiranë			43.7
Fier	Llazar Prifti		9000
Fier	Avdulla Alla		5400
Fier	Neim Cela ( Sulko )		10000
Lezhë	Anton Çupi	5000	12402.7
Durrës	Meleq Gazheli	1400	300
Durrës	Asllan Vogli	4990	310
Durrës	Ramiz Pupriqi	2684	1500
<b>Qarku</b>	<b>Emri (subjekti kërkues)</b>	<b>Sipërfaqe e</b>	<b>Sipërfaqe e</b>
Durrës	Flamur Pengili		1861
Durrës	Mustafa Gega	1855	300
Durrës	Seid Lama		708
Durrës	Muharrem Emiri	1654	152
Durrës	Iliaz Baku	1352	330
Durrës	Naxhije Bodinaku	2187	1100
Durrës	Fadil Vogli	2312	200
Durrës	Dervish Berhami	1764	900
Durrës	Sulejman Saja	2453	2420
Durrës	Sabri Keja		1180
Durrës	Sabri Keja		1180
Durrës	Sabri Keja	1835	2470

(vijon)



## YLLI MERJA:



Si të kuroni sëmundjet  
e bajameve me bimë  
mjekësore

## ÇENKUELA HASA



Alergjia ndaj  
glutenit, dieta  
çudibërëse

# ROZANA ALEKSI:



Mjekja  
gastrohepatologe:  
Kujdes, nëse vëreni  
këto simptoma,  
konsultë me  
specialistin

## Mënyrat e trajtimit të gurit në tëmth, kur duhen operuar

"Gratë dhe moshat mbi 69 vjeç,  
më të riskuar për t'u prekur"

### Cilat janë vetitë e fuqishme të rukolës në organizëm

Mjekja gastrohepatologe: Kujdes, nëse vëreni këto simptoma, konsultë me specialistin

# ROZANA ALEKSI:

## Mënyrat e trajtimit të gurit në tëmth, kur duhen operuar

"Gratë dhe moshat mbi 69 vjeç, më të riskuar për t'u prekur"

Voltiza Duro

**K**ur lëngu i grumbulluar në fshikëzën e tëmthit mpikset mund të formohen gurët në tëmth, që jo në pak raste sjellin një sërë shqetësimesh të pacienti. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe dr. Rozana Aleksa tregon të gjitha simptomat që nuk duhen neglizhuar, llojet e gurëve në tëmth si dhe mënyrat e diagnostikimit të saktë. Ajo shton se kategoritë më të riskuara janë gratë, njerëzit mbi 60 vjeç, burrat dhe gratë mbipeshe, rënia e menjëhershme në peshë, gratë shtatzëna, gratë që marrin terapi zëvendësuese hormonale, si dhe gratë që përdorin kontraceptive orale. Aleksa më tej tregon edhe të gjitha mënyrat e trajtimit për pacientët e prekur nga gurët në tëmth.

### ÇFARË JANË GURËT E TËMTHIT?

Gurët e tëmthit formohen kur lëngu i grumbulluar në fshikëzën e tëmthit mpikset ose ngurtësohet në copa të vogla materiali të ngjashme me gurët. Lëngu, i quajtur bile (lëngu i tëmthit) ndihmon në tretjen e yndyrave të ushqimit. Bila prodhohet në mëlçi, pastaj depozitohet në fshikëzën e tëmthit derisa trupit t'i nevojitet për tretjen e yndyrave. Në këtë kohe fshikëza bën kontraksione, të cilat shtyjnë bilen në një tub të quajtur duktusi biliar i përbashkët prej të cilit tëmthi kalon në zorrën e hollë duke ndihmuar në tretjen e ushqimeve. Bila përmban ujë, kolesterol, yndyra, kripëra biliare, proteina dhe bilirubine. Kripërat biliare shpërbejnë yndyrat, ndërsa bilirubina i jep feçeve (jashtëqitjes) ngjyrën e verdhe. Në qoftë se lëngjet biliare përmbajnë shumë kolesterol, kripëra biliare ose bilirubine, në situatë të caktuara formohen gurët.

### CILAT JANË LLOJET E GURËVE NË TËMTH?

Ka dy tipe gurësh në tëmth: gurë kolesterol dhe gurë pigmenti. Gurët e kolesterolit zakonisht janë me ngjyrë të verdhë në jeshile dhe përbehen kryesisht nga kolesterol i ngurtësuar. 80% e gurëve të tëmthit janë të kësaj natyre. Gurët e pig-



Mjekja gastrohepatologe dr. Rozana Aleksa

mentit janë të vegjël, me ngjyrë të errët, të përbërë nga bilirubine. Gurët e tëmthit mund të jenë sa kokrrizat e rërës deri në madhësinë e topit të golfit. Fshikëza e tëmthit mund të formojë një gurë të vetëm të madh, qindra gurë të vegjël, ose çdo kombinim të mundshëm të tyre. Gurët mund të bllokojnë rrjedhjen normale të biles (lëngut të tëmthit) n.q.s. ato vendosen në ndonjë nga duktuset prej nga rrjedh bila nga mëlçia në zorrën e hollë. Këto vendë mund të jenë: duktuset hepatiche, duktusi cistik. Lëngu i tëmthit ngelet në këto duktuse duke shkaktuar infeksion të fshikëzës së tëmthit, të vetë duktusit dhe rrallë të mëlçisë. Duktus tjetër që derdhet në duktusin biliar hepatic është dhe duktusi pankreatik i cili nxjerr enzimat tretëse pankreatike prej pankreasit. Në qoftë se gurët bllokojnë daljen e këtij duktusi, enzimat tretëse pankreatike ngelin në pankreas duke shkaktuar inflamacion shumë të dhimbshëm të quajtur pankrea-

tit. Një atak tipik shkakton: dhimbje të qëndrueshme në pjesën e sipërme të barkut, që shtohet menjëherë dhe që zgjat nga 30 min në disa orë, dhimbje në shpinë midis dy shpatullave, dhimbje nën shpatullën e djathtë, të përziera dhe të vjella. Shpesh ataku i gurëve vjen pas një vakti të pasur me yndyra dhe mund të ndodhë gjatë natës. Shenja të tjera mund të jenë: fryrje barku, intolerancë e përsëritur ndaj ushqimeve yndyrore, dhimbje në formë kolikash, gromësira, gazra, mostretje. Shumë njerëz me gurë në tëmth nuk kanë simptoma. Këta quhen paciente asimptomatike dhe gurët e tyre quhen "gurë të heshtur". Ata nuk ndërhyjnë në funksionin e fshikëzës së tëmthit, mëlçisë dhe pankreasit dhe nuk kanë nevojë për trajtim.

### NGA SE SHKAKTOHEN GURËT E TËMTHIT?

Janë zbuluar faktorë që ndikojnë në formimin e gurëve të tëmthit, në veçanti të gurëve kolesterolike. Disa prej tyre janë obeziteti, estrogeni (hormon femëror), etnia, gjinia, mjekimet për të ulur nivelin e kolesterolit, diabeti. Gratë e moshës 20 deri 60 vjeç janë dy herë më shumë të favorizuara për të bërë gurë në tëmth sesa burrat. Njerëzit mbi moshën 60 vjeç janë më të favorizuar për të bërë gurë në tëmth sesa të rinjtë.

### KUSH JANË TË RREZIKUAR TË KENË GURË NË TËMTH?

Më të rrezikuar janë gratë, njerëzit mbi 60 vjeç, burrat dhe gratë

mbipeshe, rënia e menjëhershme në peshë, gratë shtatzëna, gratë që marrin terapi zëvendësuese hormonale, gratë që përdorin kontraceptive orale.

### KURLIND NEVOJEA ENJË KONSULTE ME SPECIALISTIN?

Njerëzit të cilët kanë njëkohësisht dhe ndonjë nga simptomat e mëposhtme duhet të takojnë menjëherë mjekun: të dridhura, temperature e lehtë, zverdhje të lëkurës dhe të syve, feçe të zbardhura.

### SI DIAGNOSTIKOHEN GURËT E TËMTHIT?

Shume gurë e tëmthit, në veçanti ata të heshturit zbulohen rastësisht gjatë ekzaminimeve për probleme të tjera. Por, kur mendohet se gurët e tëmthit mund të jenë shkaktarët e simptomave, kërkohet kryerja e ekografisë së barkut. Teste të tjera diagnostikuese që mund të përdoren janë: Tomografia e kompjuterizuar (CT) skaneri i cili tregon praninë e gurëve ose komplikacionet e mundshme; Rezonanca magnetike kolonografike; Koloshintigrafia (HIDA skaner); Kolonografia endoskopike retrograde (ERCP). Testet e gjakut përdoren për të parë: shenjat e infeksionit, obstrukcionit (bllokimit), pankreatitit (inknsionit të pankreasit) ose të verdhëzës.

### CILËSHTË TRAJTIMI PËR HEQJEN E GURËVE NË TËMTH?

Heqja me kirurgji e fshikëzës së tëmthit është mënyra më e shpeshtë e trajtimit të gurëve simptomatike. Kirurgjia në këtë rast quhet kolecistektomi. Metoda më e shpeshtë dhe më e mirë e heqjes kirurgjikale të fshikëzës së tëmthit është kolecistektomia laparoskopike. Fatmirësisht njerëzit mund të jetojnë pa fshikëzën e tëmthit. Heqja e saj nuk kërkon ndryshime në dietë. Ndërsa trajtimi jo kirurgjikal përdoret vetëm në raste të veçanta, p.sh.: pacienti ka situatë serioze mjekësore që nuk lejon kryerjen e kirurgjisë dhe vetëm në rastet e gurëve kolesterolike. Terapia me tretës orale apo ajo me tretje direkte janë mënyra të tjera trajtimi.





Mjeku popullor: Kujdes, cilat janë masat që duhet të merrni për parandalim

Voltiza Duro

# YLLI MERJA:

## Si të kuroni sëmundjet e bajameve me bimë mjekësore

"Si të përgatisni çajin kundër inflamacionit të fëmijët"

**B**ajamet janë pjesë bazë e sistemit tonë imunitar e funksioni kryesor i tyre është filtrimi nga bakteret dhe çdo organizëm tjetër që mund të shkaktojë infeksione. Por ndodh që bajamet mund të vuajnë një infeksion, i cili çon në inflamacion. Tonsiliti është inflamacion i bajameve apo i grykëve. Shenjat dhe simptomat e tonsilitit përfshijnë bajamet e fryra, dhimbjen e fytit, vështirësi në gjëllitje dhe inflamacion të nyjeve limfatike në anët e qafës. Pothuajse të gjithë njerëzit kanë kaluar sëmundjen e infeksioneve në bajame një herë në jetë. Më shpesh preken fëmijët deri në 7-8 vjeç. Shkaktarët e tyre janë viruset e bakteret e ndryshme që qarkullojnë në ajër, apo që merren me anë të ushqimeve e mjedisit rrethues. Për të dalluar nëse fëmija juaj ka infeksion në bajame vërehet ngjyra e fytit, nëse është e kuqe zona e bajameve atëherë sapo ka filluar inflamacioni. Nëse dallohen zona të bardha rrethore, ato janë vatra infeksioni dhe tregojnë se infeksioni është më i avancuar dhe është më i vështirë për t'u trajtuar e shoqërohet në këto raste me temperatura të larta. Infeksionet në bajame shkaktojnë si fillim djegie të fytit, ethe, pastaj shkaktojnë humbje oreksi, dhimbje koke dhe fryrje të gjëndrave limfatike në qafë dhe probleme në kapërdimjen e ushqimit. Shkaktohet nga bakteret si stafilokokku ose streptokokku, nga viruset si influenza, por stimulohet edhe nga myku. Për t'i parandaluar infeksionet e fytit duhet të keni kujdes me higjienën e përgjithshme. Lani duart, fytyrën shpesh para ngrënies, pas testitjes ose kollitjes. Përdorni dezinfektues alkoolik në ambiente publike. Konsumoni ushqime që përmbajnë vitaminë C, të cilat rritin imunitetin, si portokalli, kivi etj. Antioksidantët janë shumë të domosdoshme të përdoren në in-



Vili Merja

feksionet e bajameve.

### KURIMI

Lyejmë lehtë bajamet me sodë buke, mjaltë dhe hudhër të përziera së bashku. Lyejmë qafën me hudhra të shtypura mirë. Kjo ndihmon në qetësimin e gjëndrave të fryra. Pihen 3 here filxhan kafe/çaji me përzierjen e mëposhtme duke hedhur në çdo filxhan çaji, për moshën deri në 5 vjeç, 4-5 pika propolis blete, ndërsa për më të rriturit 10 pika propolis.

Përgatitja e çajit për fëmijë: Në 0.5 l ujë ziejmë 2 minuta 1 lugë gjelle me frut shtogu, 1 copë lëvore vidhi, 6-8 kokrra trëndafil

të egër, dhe një lugë agulice. Kullohet pas 20 minutash. Pihet si çaj i ngrohtë. Embëlsohet me mjaltë sipas dëshirës, pihet pas buke. Shtoni në çaj propolisin, i cili është antiseptik i mrekullueshëm. Për të rriturit dyfishohet doza e përbërësve dhe masa e ujit.

Përgatitja e çajit për të rriturit: në 0.5 l verë të bardhë shtojmë 50 gr frut shtogu, një lugë dëllinje, dhe 2 lugë gjelle trëndafil të egër. Lihet 5-7 ditë. Nga kjo përzierje mund të pihen 2 filxhanë kafe në ditë. Është shumë efektive në rastet kur bajamet kanë inflamuar edhe kyçet. Pra, kjo pije shërben

edhe si qetësues i sëmundjeve reumatizmale. Në raste të përsëritjes së temperaturave të larta propolisi i bletës mund të përdoret 5-6 herë në ditë.

**KONSUMONI QEPË, KANELLË, UTHULL MOLLE, LIMONA DHE RRUSH.**

Futni një gjysmë qepë të grirë në një gotë ujë, lëreni 6 orë dhe konsumojeni lëngun dy herë në ditë. Çajet që përdoren për bajamet janë xhinxhefili, dafina, thundër-mushke, agulice etj. Për infeksione më të rënda tek të rriturit përdoret lulëkuqja, pelini i bardhë dhe frut shtogu. Këto bimë luftojnë infeksionet e rënda që shkaktohen nga stafilokok/streptokok, sepse rritin rezistencën e organizmit, dhe ulin mbrojtjen e baktereve ndaj sulmit të sistemit imunitar të njeriut, dhe kështu është më e lehtë për qelizat e bardha të sulmojnë e gjëllisin. Propolisi i bletës është luftuesi më i fuqishëm i infeksioneve të brendshme, dhe nuk mjaftohet vetëm me shërimin e bajameve. Propolisi i bletës kuron të gjitha infeksionet e bajameve pavarësisht shkaktareve. Këshillohet të përdoret dafina, ekualipti dhe sherebela në aerosol të cilat ndihmojnë në shërimin më të shpejtë të bajameve, pastrojnë frymëmarrjen. Vepron si antibakteriale të fuqishëm.

### VAKSINIMI

Vaksinimi është një mënyrë që shumë njerëz mendojnë se i mbron ndaj infeksioneve të bajameve e gripit. Por, në fakt, nuk është i këshillueshëm, pasi vaksinimi mund t'ju mbrojë nga një lloj virusi, dhe është shumë specifik, mund ta stimulojë sistemin imunitar vetëm për një lloj virusi. Viruset janë shumë të ndryshëm, dhe gjithmonë në ndryshim, prandaj vaksinimi nuk është efektiv.

Kujdes- Kur jeni me grip mundohuni të mbani distancë me njerëzit rreth jush. Kur testini përdorni shami, ose fasoletë që të zvogëlioni përhapjen e infeksionit. Gjatë një testitime përhapen rreth 100 000 pika, prandaj është shumë e lehtë të përhapet infeksioni. Infeksionet e bajameve duhen kuruar në kohe. Nëse lihen për një kohë të gjatë pa u kuruar mund të shkaktojnë inflamacione në kyçe dhe palcën e kuqe të kockave duke dhënë shenja të sëmundjeve reumatizmale, në moshat fëmijërore.



Voltiza Duro

# ÇENKUELA HASA: Alergjia ndaj glutenit, dieta çudibërëse

**E**dhe pse mund ta dëgjoni çdo ditë apo ta lexoni në ushqime të ndryshme "gluten frw", shumë persona akoma nuk e dinë sesi mund ti kenë marrëdhëniet me glutenin. Blogerja healthy-lifestyle, Ccenkuela Hasa tregon për suplementin "Life Pages" në Gazeta Shqiptare, mënyrat për të verifikuar alergjinë nga gluteni.

**SIMPTOMAT**

Në mund të hamë shumë pak por prapë ndjehemi të fryrë, dhe nuk marrim rezultate nga një dietë. Në mund të jemi nën peshë pasi personat që janë alergjik ndaj glutenit zakonisht janë mbi ose nën peshë. Që të konfirmoni që jeni në një marrëdhënie jo të mirë me glutenin, jo patjetër duhet të keni të gjitha simptomat, por për ta zbuluar këtë ju duhet të bëni ekzaminimet përkatëse. Edhe para çdo diete ju duhet të njihni trupin tuaj. Nëse ndiqni një dietë, në fillim sigurohuni që të gjithë parametrat tuaj funksionojnë normalisht. Gluteni është një proteinë e cila gjendet në grurë dhe përbëhet nga dy proteina kryesore si, gliadin dhe glutenin. Gluteni gjendet në elb, thekër, grurë. Disa nga ushqimet që përmbajnë gluten janë makaronat, buka, dhe tërshëra e cila është klasifikuar si e tillë. Glutenin mund ta gjeni edhe në produkte të tjera prandaj është shumë e rëndësishme të lexoni përbërësit nëse jeni alergjik ndaj glutenit.

**ALERGJIA NDAJ GLUTENIT**

Çdo të thotë të jesh al-

ergjik ndaj glutenit? Te personat që janë alergjik ndaj glutenit ose kanë sëmundjen e celiac, ngrënia e ushqimeve me përmbajtje gluteni shkakton një reaksion autoimunitar ku dëmtohet membrana e zorrëve të vogla, e cila mund të ndikojë në gjithë trupin. Zorrët tretin në mënyrë shumë të ngadaltë ushqimet. Pasojat nga një person te tjetri ndryshojnë, duke filluar nga më të lehtat deri te më të ndërlikuarat. Disa prej pasojave që mund të shkaktojë gluteni janë humbje peshe, depresion, sterilitet, rënie flokësh, irritime lëkure, osteoporozë, dhimbje kyçesh, lodhje, pafuqi madje deri në aborte spontane.

**SHKAKTARËT**

Shkaktarët se pse disa persona kanë alergji ndaj glutenit nuk janë zbuluar, por mendohet të jenë gjenetikë. Ata që vuajnë nga sëmundja e celiac duhet të ndjekin gjithë jetën këtë regjim, për të shmangur në këtë mënyrë problemet. Por çfarë duhet të keni parasysh nëse ju vuani nga celiac? Fillimisht duhet të eliminoni ushqimet me përmbajtje gluteni, duhet të lexoni gjithmonë përbërësit para se të bleni diccka, nuk duhet të pini pije të gazuara apo birra që përmban gluten. Gjithashtu nuk duhet të konsumoni asnjë ushqim të konservuar dhe të rriini sa më



larg ushqimeve të shpejta.

**DIETA PA GLUTEN**

Në botë sot është një ndër dietat më të kukuara. Efektet e saj janë të shpejta, sepse në dietën pa gluten kemi ulje të karbohidrateve, këto të fundit ndikojnë në fryrje dhe shtim peshe. Nuk është vërtetuar shkencërisht që gluteni ndikon në humbje peshe, por vetë stili i jetesës që të ofron dieta pa gluten ndikon të kemi një proces të tillë. Kjo dietë ndiqet jo vetëm nga personat që vuajnë nga sëmundja celiac. Dieta pa gluten ndiqet dhe nga personazhe të njohur ndërkombëtarë. Të ndjekësh një regjim të tillë do të thotë të eliminosh të gjitha ushqimet me përmbajtje gluteni si dhe ushqimet e nënproduktet që vijnë nga gruri.

**AKTIVITETI FIZIK**

Gjithmonë themi që aktiviteti fizik duhet praktikuar, por në këtë rast duhet të themi që ushtrimet mund të ndikojnë pozitivisht por mund të ndikojnë edhe negativisht. Prandaj duhet të tregoni kujdes dhe të mësoni sesi aktiviteti ndikon në shëndetin tuaj nëse ju jeni alergjik ndaj glutenit. Një mëngjes pa gluten përmban: 1 lëng portokalli, 1 vezë të zier, 1 kafe pa qumësht. Një drekë pa gluten përmban: 1 sallatë mikse, 1 fileto pule, 1 frut sipas dëshire. Ndërsa një darkë pa gluten përmban: oriz, bizele, sallatë me lakër të kuqe.



# Këshilla



## Cilat janë vetitë e fuqishme të rukolës në organizëm

Rukola i përket familjes botanike Cruciferae që përfshin brokolin, lakrën dhe lulelakrën, e në përbajtjen e saj ka shumë vitamina, minerale dhe ushqyes. Vitamina K që gjendet tek rukola lufton inflamacionin dhe forcon shëndetin e kockave, duke parandaluar në të njëjtën mënyrë edhe shfaqjen dhe zhvillimin e artritit. Një vlerë e shtuar e vitaminës K është edhe ndihma që i jep organizmit për të përthithur kalciumin, duke i dhënë një mbështetje të fortë personale që vuajnë nga osteoartriti. Vitamina C mbështet sistemin imunitar dhe shmang rreziqet e shfaqjes së infeksioneve dhe sëmundjeve dhe në vetvete është një mekanizëm që mbron, sulmon dhe shkatëron të gjitha radikalet e lira që shkaktojnë probleme të rrezikshme. Rukola përmban vitaminë A e cila është një antioksidant i fuqishëm dhe që promovon shëndetin e mirë të kockave, dhëmbëve, syve dhe lëkurës. Indole-3-Carbonol (I3C) është një përbërës, që sipas të dhënave shkencore ekuilibron nivelet e hormoneve. Rukola është



e pasur me këtë përbërës. Nëse e krahasojmë me ushqime të tjera siç janë spinaqi, bajamet, bimët bishtajore apo gjethet e panxharit, rukola përmban një sasi më të vogël të oksalatit. Kjo është një molekulë që parandalon përthithjen e kalciumit. Kjo e bën rukolën të dobishme për t'u konsumuar, sepse ushqyesit e saj sigurohen që kalciumi të përthithet plotësisht. Ushqimet e pasura me molekulën e lartpërmendur, siç është spinaqi, mund të promovojnë formimin e gurëve në veshka. Rukola nga ana tjetër, ul rrezikun e formimit të këtyre gurëve, pikërisht falë sasisë së ulët të molekulës

oksalate. Rukola është një barishte e sigurt për të gjitha femrat shtatzënë. Acidi folik, një prej vitaminave të kompleksit B, ul rreziqet e formimit të defekteve në lindje për foshnjat e sapolindura. Acidi pantotënik (vitamina B5) ka një ndikim të favorshëm kundër niveleve të larta të kolesterolit. Rukola ka potencialin të përmirësojë kolesterolin e mirë dhe të ulë kolesterolin e keq në trup. Vlerat e shtuara të rukolës përfshijnë edhe aftësinë për të pastruar organizmin dhe kundërvepruar ndaj efekteve helmuese të toksinave të metaleve të rënda. Rukola ka fuqinë të eliminojë pesticidet dhe herbicidet nga organizmi.



## Përdorimet e aloe verës për një lëkurë të shëndetshme

Aloe Vera njihet tashmë për vlerat e saj për shëndetin e organizmit. Tek vetitë e saj përfshihen dhe përmirësimi dhe parandalimi i problemeve me shëndetin e lëkurës. Janë të shumtë në numër produktet farmaceutike për kujdesin e lëkurës që e kanë si përbërës kryesor pikërisht aloe verën e cila ushqen dhe hidraton lëkurën, eliminon aknet si dhe pastron poret dhe largon qelizat e vdekura.

### Për lëkurë të thatë

Xheli i aloe verës ka veti shëruese dhe hidratuese prandaj është dhe ideal për lëkurat e thata. Ajo i mundëson këtyre tipe lëkurash ushqimin e nevojshëm. Mund ta përdorni xhelin e saj duke e vendosur direkt në lëkurë.

### Pastrues i lëkurës

Pastrimi i lëkurës së fytyrës nga papastërtitë dhe qelizat e vdekura është një nga hapat kryesorë të një lëkurë të shëndetshme. Proveni të përzieni xhelin e aloe me pak sheqer dhe të fërkoni lëkurën e fytyrës kur e lani në darkë. Në saj të veçorive shëruese aloe vera parandalon dhe acarimin e lëkurës si dhe hidratimin e saj.

### Krem ushqyes

Lëreni aloe verën të bëj magjinë e saj gjatë kohës që ju flini. Lyeni fytyrën, qafën dhe duart me xhelin e aloe para se të flini. Kjo bimë nuk ka përbajtje vajore dhe është delikate me lëkurën teksa depërton shtresat e saj. Kështu mundëson një hidratim rrënjësor të lëkurës duke e lënë atë të butë dhe të shkëlqyeshme.

### Qetëson aknet

Aloe vera ka veti antibakteriale, anti inflamatore dhe anti alergjike. Këto bashkuan me vlerat e larta ushqyese bën të mundur eliminimin e shenjave dhe akneve. Përdorni aloe verën duke e përzierë me lëngun e limonit për të luftuar shenjat dhe njollat kafe në fytyrë

Vuçiç pritet t'i drejtohet kombit pas protestës

'Fashistët dhe hajdutët', presidenti serb shpërthen ndaj protestuesve

Reth dy mijë protestues rrethuan pallatin presidencial në Beograd, ndërsa Presidenti Aleksandër Vuçiç dha një konferencë shtypi mbi episodet e të shtunës në televizionin publik. Presidenti i Serbisë komentoi hyrjen e protestuesve në ndërtesën e TV, ndërsa i etiketoi ata me një gjuhë të ashpër si "fashistë dhe hajdutë".



nëse qindra mijëra protestues zbresin në rrugë. Ishte mbresëlënëse që Vuçiç, gjatë konferencës për shtyp, vazhdimisht mori shënime nga kolegët e tij që e informonin atë për situatën jashtë pallatit presidencial. Çdo herë që ai njofton se çfarë po

bëjnë partnerët e tij, ai thotë se nuk ka frikë dhe nuk do të tërhiqet. Një nga mesazhet, pohoi ai, erdhi nga serbët e Kosovës të cilët shprehën gatishmërinë e tyre për të ardhur në Beograd për ta mbrojtur atë. Udhëheqësit e opozitës për-

ballë pallatit presidencial thonë se demonstruesit do të vazhdojnë të bllokojnë ndërtesën për të parandaluar Vuçiçin të largohet. Sidoqoftë, është e dyshimtë nëse Vuçiç do të zgjedhë të dalë nga hyrja kryesore, pasi siç dihet, pallati presidencial ka gjithashtu një tunel nëntokësor që largohet nga ndërtesa. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç iu adresua kombit, vetëm një ditë pasi protestuesit u futën në ndërtesën e Radio Televizionit të Serbisë, për të kundërshtuar, siç u shprehën ata, mbullimin e njëanshëm të ngjarjeve nga ky televizion. Demonstrues-

it, që po protestojnë kundër Vuçiçit u nxorën me forcë nga ndërtesa e Radio Televizionit të Serbisë, pasi kishin qëndruar aty për dy orë. Policia serbe arriti brenda ndërtesës së Televizionit dhe nxori jashtë protestuesit. Në mesin e protestuesve ishin edhe udhëheqësit e Aleancës për Serbinë, një grupi prej rreth 30 partish politike dhe lëvizjesh të ndryshme. Pasi protestuesit u nxorën nga ndërtesa e RTS, njerëzit u mblodhën jashtë për të kundërshtuar veprimet e policisë. "Në muajt e fundit ne po kërkojmë vetëm një gjë - që organizatorët e protestës të lejojnë të flasin në televizionin shtetëror, tha Bosko Obravac, lider i partisë Dveri.

SHKURT

'Vizat për Kosovën', Kadri Veseli: Ky është një turp për BE-në

Kadri Veseli, kryetari i Kuvendit, në një intervistë për gazetën austriake "Der Standard", ka folur për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ai ka shprehur kritikë në drejtim të Bashkimit Evropian. Krye parlamentar shprehet mes tjerash se është i pakonceptueshëm veprimi i BE-së, i cili vijon të mbajë peng nga lëvizja e lirë kosovarët, në një kohë kur të gjitha kushtet janë plotësuar. "Ku është dënjëti i BE-së, ku janë vlerat?" pyet ai. "BE duket se është në një krizë të madhe, sepse një vend në Evropë me 1.7 milionë banorë, që janë shumë evropian, tani duhet të paguajë për këtë krizë", tha Veseli për median austriake.

Ende në azil, Gruevski kërkon heqjen e masës së paraburgimit

Ish-kryeministri, Nikola Gruvski pasi u arratis në Budapest të Hungarisë, iu dha masa e paraburgimit për veprat për të cilat ai u akuzua. Por, ai i është drejtuar Gjyqit të Apelit në Shkup për të kërkuar që t'i ndërpritet masa e paraburgimit. Këtë e ka treguar raporti i shtatë me radhë i PSP-së, ku ekipi i Katlica Janevës këtë raport e publikon çdo gjashtë muaj. Ankesat, të cilat i ka parashtruar përmes avokatit të tij, janë pezulluar si të pabaza. "Masë paraburgimi i është ndarë ish-kryeministrit në lëndët "TNT", TRAJJEKTORJA" si dhe "DHUNA NË QENDER". Megjithatë, në të gjitha lëndët po gjykohet në mungesë.

Shoqëria civile kundër Gjukanoviç

Mbrëmjen e të shtunës mijëra malazezë mbushën sheshin qendror të kryeqytetit, për të kërkuar dorëheqjen e Presidentit Milo Gjukanoviç dhe kryeministrit Dusko Markoviq. Manifestuesit tërërishtin "Milo hajduti" dhe mbanin në duar parulla ku presidenti dhe qeveria e demokratëve socialistë të drejtuar prej tij akuzoheshin blejje votash në zgjedhjet presidenciale të 2018-ës, po ashtu edhe për korrupsion dhe abuzim me detyrën. "30 vjet më parë ne e nisëm nga ky vend. E sollëm zotin Gjukanoviç në pushtet. Por ai e tradhatoi popullin e vet. Konkuzioni është i thjeshtë: Rruga e zgjidhi atë dhe rruga do ta largojë". Protestat e nisura prej Shkurtit organizohen nga grupe të shoqërisë civile. Një ndër organizatorët është biznesmeni Dusko Knejevciç, ish-aleat i Gjukanoviçit. Partitë e opozitës nuk janë të mirëpritura në manifestime, pasi, siç thanë pjesëmarrësit, ato janë të përcara dhe popullit nuk ka besim në to. Kusht për bashkëpunimin, protestuesit kanë vënë lënien e mandateve parlamentare nga deputetët e opozitës. Gjukanoviç është në pushtet prej 30 vitesh, herë si President e herë si Kryeministër.

Daçiç: Britania e Madhe e Gjermania s'e përkrahin ndarjen e Kosovës

Ndryshimi i kufijve, Haradinaj: Askush s'merr tokë më nga shqiptarët

Mustafa: Të vetëshkarkohet qeveria, të shkohet në zgjedhje

Ditën e djeshme kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka reaguar për çështjen e korrigjimit të kufijve me Serbinë, ndërsa nuk harron të përcjtojë një mesazh të qartë për ata që mbështesin këtë ide. Ai ka pohuar se nuk ka tokë për të dhënë Kosova duke shtuar se lufta është bërë për kufijtë. "Ne në Kosovë jemi në të drejtën tonë, por jemi në kohën kur duhet të kujdesemi për tokën tonë, për vendin tonë. Dihet ndër shekuj se shqiptarët kanë dhënë nga toka që u ka lënë Zoti. Kur e them atë që është e shqiptarëve, kurrë nuk harroj të them se kushdo që jeton me ne, komunitetet etnike, janë në shtëpinë e vet dhe ne dimë t'i nderojmë, por nuk ka më kthim prapa dhe nuk ka më vazhdim të praktikave të merret prej shqiptarëve. Brezi i UÇK-së e ka ndryshuar këtë, rrjedhat e historisë kanë ndryshuar dhe prej shqiptarëve më askush nuk mund të marrë", ka thënë Haradinaj. Nga ana tjetër kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" tha se qeveria e Kosovës duhet vetëshkarkuar. Mustafa fajësoi qeverinë e Prishtinës se me takсэн ndaj Serbisë e shkakton më shumë probleme vetes, kurse ka kërkuar që vendi të shkojë në zgjedhje. "Të nderuar qytetarë, tarifën e kësaj qeverisjeje nuk po e paguan Serbia dhe Bosnja. Një qind për qind po e paguan Kosova. Deri sa drejtorja e Doganave deklaroi se importet nga këto vende kanë rënë 99%, shitorët janë përplot me mallra serbe e boshnjake. Kështu thonë qytetarët! Nderkaq ne gjithnjë e më shumë po e paguajmë takсэн/tarifën e evazionit fiskal, korrupsionit, nepotizmit, punësimit partiaik; po e paguajmë lobimin e njërit dhe tjetrit, kapjen e kompanive publike; po e paguajmë targën e abstenimit të prokurorisë dhe gjyq-



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

sisë ndaj shkeljeve dhe abuzimeve; targën e shkeljeve të Kushtetutës si pasojë e pazareve të koalicionit qeverisës për votat që i mungojnë për të qeverisur. Në Kosovë, për më shumë se një vit, dialogu për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë ka bërë që institucionet dhe opinionin publik të mos merren me zhvillim ekonomik, punësim, arsim e problemet e shëndetësisë. Thua se ushqimi për popullatën tonë është dialogu, se arsim është dialogu e shëndet është dialogu me Serbinë?! Dialogu është shëndërruar në garë për t'ia treguar njëri-tjetrit muskujt brenda koalicionit të brishtë qeverisës, por edhe një instrument për të mbajtur

pushtetin. Është bërë si arenë e gladiatorëve, ku sunduesit e zhvendosnin vëmendjen e qytetarëve nga problemet e tyre. Nëse dikush nga koalicioni i qeverisë e do këtë vend, dhe nuk dyshoj se ka të tillë, "ka shkruar Mustafa. Nderkaq ministri serb i Punëve të Jashtme, Ivica Daçiç, ka thënë se me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare kurrë nuk ka pasur bisedime lidhur me se çfarë dëshiron Serbia si rezultat përfundimtar në negociatat me Kosovën. "Nuk kemi ardhur të këto tema. Sa herë që është hapur një mundësi për të shkuar drejt kompromisit, gjithmonë ka ndodhur ndonjë incident. Këto nuk janë vetëm dy-

**RAMUSH HARADINAJ**  
"Ne në Kosovë jemi në të drejtën tonë, por jemi në kohën kur duhet të kujdesemi për tokën tonë, për vendin tonë. Dihet ndër shekuj se shqiptarët kanë dhënë nga toka që u ka lënë Zoti. Kur e them atë që është e shqiptarëve, kurrë nuk harroj të them se kushdo që jeton me ne, komunitetet etnike, janë në shtëpinë e vet dhe ne dimë t'i nderojmë, por nuk ka më kthim prapa dhe nuk ka më vazhdim të praktikave të merret prej shqiptarëve", ka thënë Haradinaj.

Daçiç, përcjell Telegrafi. Ndërsa, lidhur me mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare deri në fund të këtij viti, Daçiç tha se "kjo do t'i takonte fantastikës shkencore politike". Ai thekson se duhet të hiqet taksa ndaj mallrave serbe në mënyrë që të vazhdojë dialogun, "por fakti se ata [Kosova] nxori Platformën për dialog, kjo na vë në një pozicion të ri politik - se ata nuk duan asnjë kompromis". Kreu i diplomacisë serbe tha se Platforma e Kosovës për dialog nuk i intereson fare. Daçiç përkujton dy pozicione krejtësisht të kundërta, mes palës serbe dhe kosovare në bisedime. "Njëra është se Kosova është një autonomi në kuadër të Serbisë, dhe tjetra është se Kosova është një shtet i pavarur brenda kufijve të saj, "të cilët ata i paraqesin si ndërshtetërore", të cilat, në fakt, janë kufij me krahinës dhe Serbisë qendrore", tha Daçiç. "Vështirë është të arrihet deri të kompromisi, mbi bazën e këtyre dy pozicioneve. Pse amerikanët kanë lëvizur nga pozicioni i tyre? Sepse e kuptuan se Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën e pavarur, pa ndonjë kompromis. Dhe, cili është kompromisi? Ata kurrë nuk kanë thënë se kjo është zgjidhja më e mirë. Ata vetëm thonë, të shohim se cilat janë propozimet", ka thënë Daçiç.

Babai i euroskeptikëve: Të çinstalohet BE e të ketë bashkëpunim të lirë

# Flet Vaclav Klaus: Ja si do të dalin zgjedhjet europiane

"Të kundërshtohen emigrimet e t'u kthehet vendimmarrja shteteve kombëtare"

Të flasësh për Europën me Vaclav Klaus do të thotë të konfrontohesh me atë që kontinentin e ka parë të përcarë, të copëtuar, të shqyer nga ideologjitë e '900 dhe në fund të bashkuar nën atë flamur blu me yje që e ka kritikuar qysh nga momenti i parë. Domethënë qysh kur ka nisur të hedhë farën e euroskepticitizmit, jo vetëm si kryeministër çekoslovak, por edhe si president i Republikës Çeke (nga viti 2003 deri më 2013). I tij mund të përkufizohet si një mendim proto - sovranist, edhe pse si profil akademik shfaqet gjithmonë si një liberal i bindur. Thjesht, në mënyrën më politikisht korrekte të mundshme, theksojnë se për të shpëtuar Europën si entitet është e nevojshme të çinstalohet Bashkimi Europian si superstrukturë dhe të kalohet në një bashkëpunim të lirë midis vendeve që aktualisht e përbëjnë, duke ruajtur lirinë e lëvizjes pa hequr kufijtë. "Gli Occhi della Guerra" e kanë takuar me rastin e vizitës së tij në Romë, i ftuar me librin e tij, "Të kuptosh emigracionin" (shtëpia botuese Giubileo Regnani) në kuadër të Europës Sovraniste të organizuar më 9 mars nga "Think Tank Nazione Futura".



Vaclav Klaus

"Jo. Nuk do të ketë ndryshime kaq të thella. As formimi i një konstelacioni të ri potencial anti Bashkim Europian brenda Parlamentit Europian nuk do të jetë i mjaftueshëm. Nevojiten ndryshime të thella në mentalitetin e qytetarëve".

**Projekte si Internacionala Sovraniste e Matteo Salvini dhe The Movement i Steve Bannon nuk mund ta përshpejtojnë këtë vetëdijësim nga ana e popujve?**

"Me hidhërimin tim më të madh, nuk e kam takuar kurë zotin Salvini, që gjithsesi nuk e konsideroj një populist të djathtë. Idetë e Steve Bannon më pëlqejnë shumë, jemi konfrontuar shpesh dhe mendoj se influenca e tij potenciale mund të jetë pozitive. Por do të tentoj që të mos e mbivlerësoj".

**Cila do të ishte receta juaj për ndryshimin e Europës?**

"Problemet e Bashkimit Europian kanë shumë dimension. Në nivel legjislativ, do të

duhej të ktheheshim në një qasje paraMaastricht (dhe, natyrisht, ti themi lamtumirë Traktatit të Lisbonës). Veç kësaj, të dyja shtyllat kryesore e "bashkimit" të epokës së fundit - Marrëveshja e Schengen dhe euro - do të duhej të rishikoheshin. Së fundi, duhet të kundërshtojmë emigrimet në masë dhe t'ua kthejmë pushtetin vendimmarrës shteteve kombëtare".

**Me pak fjalë, të rifillohet nga zero.**

"Mjafton të lexohet manifesti i Emmanuel Macron për të kuptuar faktin se Europa kështu siç është nuk ka arsye të ekzistojë. Jo vetëm është e gabuar, por edhe jashtëzakonisht e rrezikshme. Në thelb, europelistët do të donin ta transformonin Bashkimin Europian në një subjekt akoma më të rregulluar, më të burokratizuar, më progresist. Vende si Italia - ashtu si Republika Çeke - duhet të luftojnë bashkë për të ndryshuar modelin aktual e integritetin europian. Në rast se përpjekja jonë

e përbashkët do të dështonte, lënia e Bashkimit Europian do të bëhej një opsion. Për ta kuptuar, mjafton të shikohen dy dekadat e stancionimit dhe të performancës së dobët ekonomike të pësuar nga vendi juaj pas adoptimit të euros".

**Ju konsideroheni babai i sovranizmit në Europë. Për të përkufizuar teorinë tuja politike është krijuar deri edhe një term: klausizmi. Kush lider europian e interpreton më mirë këtë doktrinë?**

"Më josh shumë fakti që konsiderohem si babai i klausizmit. Në realitet, 28 vite më parë, kur themelova Partinë Civile Demokratike, e quajta veten thjesht konservator nga pikëpamja politiko - kulturore dhe liberale në ekonomi. Në të vërtetë, mendimi im, që aq shumë u pëlqen bazave militante, nuk ka kaq shumë mbështetës në nivelet drejtuese të politikës. Le të themi se, megjithatë duke qenë ai klausist, konfrontohem shpesh me zotin Orbán. Kemi shumë pikëpamje të përbashkëta".

**Ja, për sa u përket grupit të Vishegradit. Forcat e majta e të gjthë kontinentit mendojnë se ky bllok është një prej problemeve kryesore të Bashkimit Europian. Si domos për sa u përket pozicioneve në temën e emigracionit dhe të rishpërndarjes së emigrantëve. Çfarë mendim keni?**

"Rishpërndarja e emigrantëve është një ide progresiste e papranueshme që synon në ristrukturimin etnik të kontinentit tonë dhe në erozionin gradual të identiteteve kombëtare. Në vend që të

mbrojnë kufijtë e Bashkimit Europian, elitat europiane propozojnë këtë projekt inxhinierie sociale që kërcënon historinë, kulturën dhe traditën e vendeve të veçanta. Vendet e Grupit të Vishegradit janë konfrontuar nga afër me ideologji të kësaj natyre dhe janë ngurruese në përsëritjen e përvojave të tilla të ngjashme".

**Nga Shtetet e Bashkuara, tek Hungaria dhe deri në Australi, në të gjithë botën rriten masat e survejimit dhe të mbrojtjes së kufijve. Është ku drejtimi i duhur për t'u ndjekur që t'i jepet fund krizës së emigrantëve?**

"Të gjitha shoqëritë bazohen mbi kufij, tela me gjemba, mure. Është e pamundur që të çlirohemi prej tyre. Në kemi jetuar për vite të tëra nga ana tjetër e Perdes së Hekurt, megjithatë nuk e kemi menduar kurrë që të teorizojmë një heqje totale të kufijve". A nuk do të ishte rruga më e thjeshtë për ndalimin e emigrantëve ajo e mbështetjes më shumë e shteteve afrikane?

"Jo me ndihmat humanitare, shpërdorime parash në kuptimin e vërtetë të fjalës që përfundojnë në xhepat e politikanëve dhe të burokratëve të korruptuar. Forma e vetme më efektive e ndihmës është e ajo e tregimit lirish të këto vende, pa kuota, pa kufizime, pa barriera burokratike dhe pa imponuar standarde sociale, mjedisore dhe të çdo lloji tjetër".

**Qeveria italiane akuzohet shpesh se i shkel synin Rusisë. Ju që keni jetuar si protagonist fazat më të pas pasovjetike a arrini ta kon-**

**sideroni si një bashkëbisedues?**

"Kemi vuajtur për dekada dominimin perandorak sovjetik. Për këtë arsye jemi ndosh-ta hiper të ndjeshëm ndaj Rusisë. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm për ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur pas rënies së komunizmit. Duhet t'i pranojmë dhe t'i respektojmë. Nuk janë të mjaftueshëm, por as të anashkalueshëm. Jam i bindur se duhet qenë logjike pranimi i Rusisë si një vend me ambicet dhe me interesat e veta. Italia ka mundësi që po vepron më mirë se shtetet e tjera europiane".

**Po për sa u përket superfuqive të tjera? I konsideroni Kinën dhe Indinë si mundësi apo kërcënime potenciale?**

"Kina, India, Rusia dhe të gjitha vendet e BRICS-it duhet të jenë partnerë normalë. Atë që do të doja refuzoja me forcë është ideja se duhet të luftohet një Luftë e Ftohtë e re. Në i kemi qenë viktimë, dimë diçka".

**A ka një rrezik islamizimi të Europës?**

"Islami është një besim fetar islamizimi është kërcënim. Është mirë që të frenohet dhe që të mos importohet - aq më pak qëllimisht - në Europë. Në përgjithësi, e konsideroj multikulturalizmin si një ideologji kolektiviste e majtë e epokës moderne. Por, për të qenë i ndershëm, më duhet të pranoj se multikulturalizmi është një pasojë e mënyrës tragjike e mendimit pasmodern, që përfshin edhe universalizmin artificial që parashikon dominimin e kulturës perëndimore".

MARRË NGA BOTA.AL

## Masakra në Zelandën e Re, sulmuesi veproi i vetëm

### Akti terrorist në dy xhamitë, kryeministrja e vendit: Do rishikohet ligji i armëve

Brenton Tarrant, 28-vjeçari i akuzuar si autori i sulmit në dy xhami të Zelandës së Re, thuhet se ka vepruar i vetëm. Kjo pistë konfirmohet deri tani nga policia vendase. Tre persona të tjerë që u arrestuan pas sulmit si bashkëpunëtorë të të dyshuarit, nuk janë të përfshirë në ngjarje, raporton BBC. Nga sulmi me armë në dy xhami mbetën të vrarë 50 persona. Rreth 34 të tjerë mbetën të plagosur dhe ndodhen të shtruar në spital për trajtim mjekësor. Një vajzë 4-vjeçare është në



gjendje të rëndë. Kryeministrja e Zelandës së Re ka paralajmëruar se do të rishikohet ligji i armëve në vend pas sulmit të rëndë që tronditi vendin. Akti terrorist i

28-vjeçarit u transmetua live në 'Facebook' nga vetë sulmuesi. 'Facebook' njoftoi më vonë se e kishte fshirë videon që kishte marrë më shumë se 1.5 milionë

shikime. Brenton Tarrant doli para gjykatës të shtunë me pranga në duar dhe duke buzëqeshur para kamerave. Ai është akuzuar për vrasje, por në vijim pritet që ndaj tij të ngrihen edhe akuzat e tjera. Ai kish-të leje për të mbajtur armë dhe posedonte 5 të tilla. Nga të dhënat është konfirmuar se nuk ka pasur dosje penale të mëparshme, por ka qenë në fokus të shërbimeve të sigurisë në Zelandën e Re dhe Australi, vendin e tij të origjinës.

AUSTRALI/ MINORENI E QËLLON ME VEZË, SENATORI E GODET

FOTOLAJM

Një ngjarje e 'pazakontë' ka ndodhur në Melbourne të Australisë. Senatori, Fraser Anning është qëlluar me vezë nga një 17-vjeçar teksa po fliste përpara mediave. Një ditë më parë ai fajësoi myslimanët për sulmin terrorist brenda dy xhamive në Zelandën e Re, ku mbetën të paktën 49 persona të vdekur.

# Shtatë gabimet e Zaevit

Nga Arsim Sinani

(vijon nga faqja 1)

... Perëndimit. Një nga shkaqet është keqpërdorimi i mjeteve të dedikuara për kampanjë, grantet dhënë OJQ-ve pa peshë nga jashtë e brenda dhe vetë kënaqësia me egon e liderit. Te shqiptarët u pa vetëm spoti me Ali Ahmetin që irritoi dhe dekurajoi votuesin shqiptar pasi që në kontinuitet ka pasur premtime dhe realizime për të mos u dëshiruar. E kur kampanjën e drejtojnë njerëz që ia putnin dorën Putinit sllavomagedonas Gruevski, s'do mend se numri i votuesve duhet të thuhet se ishte i madh. Biçikleta me goma të plasura si model perëndimor nuk i ndihmoi njerëzve të deridjeshëm të zhytur në korrupsion të ia hedhin tutje. Ajo masa kritike shqiptare nga dëshpërimi se në pushtet mbet mentaliteti i deridjeshëm me trashëni dorë ia ka mësyr Perëndimit në kërkim të një jete më të mirë. Elementi i vendosjes brenda qeverisjes së shqiptarëve pa peshë politike është edhe një argument shtesë se pse referendumi dështoi. Opozita shqiptare nuk arriti të komunikojë me elektoratin pasi që mediat nuk u dhanë hapësirën minimale për ta mobilizuar elektoratin. Mediat kanë nevojë të demokratizohen dhe lirohen nga redaktorë partiakë. Pamë analiza boshe por nuk u shtjellua realiteti, problemet, çështjet etj. Një element tjetër që po anashkalohet ishte diaspora posaçërisht ajo shqiptare që zakonisht e mbush arkën e shtetit e në rastin konkret iu kohua e drejta e votimit. Kur ju ia kushtëzoni votën diasporës, e cila është motor atëherë nuk mund të pritni rezultat konkret. Diaspora shqiptare alarmoi se çështja shqiptare po anashkalohet dhe se shteti i riemëruar vazhdon me avazin e vjetër, por kjo nuk u dëg-



ju nga një ndërkombëtarët. Ndërsa partitë shqiptare me lazdrinë e zakonshme e shtynë çështjen shqiptare pa e përdorur Badinterin pa të cilin nuk kalon asnjë ligj pa u votuar nga shumica shqiptare. Por inati i një lideri, të cilit po i fundoset anija e shtyu më tutje zgjidhjen e çështjes shqiptare. Pa e harruar atë se shqiptarët këtë herë votuan për Perëndimin e jo për marrëveshjen, e cila ishte thjeshtë kontinuitet, i cili një vetëm njëri etni dhe ndërton shtet mbi kurrizin e shqiptarëve. Por identiteti shqiptar në FYROM është i fortë dhe imun ndaj sulmeve por virusi i brendshëm është i paparashikuar. Shqiptarët në IRJM nuk kanë filozofi politike kjo është çështja dhe nuk është ndërthurur strategji e veprimit. Ideja e fragmentarizimit të faktorit shqiptar

fatkeqësisht do vazhdojë me ritme të shpejta në FYROM. Disa janë faktorët e kësaj: mospërgjegjësia, mungesa e kulturës demokratike, inatet e pakuptimita, mospasja doktrinë, niveli i ulët i shkollimit, dobësimi i fuqisë politike si rezultat i ndikimit të faktorit sllavomagedon dhe bajraktarizmi pafund i liderëve etj. Marrëveshja e Prizrenit u zhbë, Marrëveshja e Ohrit nuk u zbatua, Marrëveshja e Tiranës u shkel, këshilli koordinues u prish, tryeza u shpërfill. Këto janë fakte drithëruese se kah po shkojnë shqiptarët në FYROM. Ndërsa në taborrin sllavomagedonas situata paraqitet mjaft problematike

Shoqatat ruse dhe investimet kapitale deri në media tregoi se ishin efektive në rastin e FYROMIT. Lëvizja pansllaviste e pap-

enguar lëvizti në zobat më të thella duke propaganduar tezën se sllavët marrin fund nëse kyçen me Perëndimin. Këtu rol primar lozi edhe agjencitura serbe, e cila me gjithë arsenalin e saj ndikoi në bojkotin e qytetarit sllav. Ndërsa partia VMRO me njerëzit e saj u besua se a do ndikojë, por u pa se taktika me Gruevskin pas grilave ishte bllof. Kjo strukturë e ndihmuar nga këto forca arriti ta bllokojë procesin dhe tregoi se e do martir liderin e vet të zhytur në krim gjatë qeverisjes. VMRO mbetet e fuqishme në biznes, media, strukturat e sigurisë dhe te një pjesë e fortë e BDI-së sepse u lidhen bizneset e punët që i kanë realizuar bashkë. Krahu serb e rus është i fortë brenda VMRO ndërsa krahu bullgar mbetet i dobët fatkeqësisht, por edhe ai me perëndimin. Problemi tjetër është

të se partia e Zaevit me shumë lehtësi iu fut referendumit pa punuar seriozisht. Partia e Zaevit nuk punoi seriozisht duke menduar se ardhja e Merkel, Mogerini, ShBA e tërë botës demokratike është çështje e mbyllur. Por e harroi qytetarin e varfëruar të cilit nuk iu shpjegua çështja dhe ai mbeti i izoluar me barkun bosh e xhepat e zbrazët. Mendjelehtësia në këtë proces e lejoi që situata të mbetet si para referendumit, nuk shihen reforma. Pasi e tjetërsoi rënien e Gruevskit Partia e Zaevit parapëlqeu t'i merrte disa shqiptarë pa influencë dhe t'i përdorë për nevojat shtetërore duke harruar se ka parti shqiptare me të cilat qeveris. Zaevi është meritues në fitoren e vjedhur që ia bëri opozitës shqiptare duke i mbajtur në pushtet kryetarët e harxhuar të partisë së Ali Ahmetit. Ky ishte devijim dhe nënçmim i votës shqiptare nga ana e Zaevit. Harroi ky Zaevi se ishte ky mentalitet që ia dha shkelmin paraardhësit të tij, i cili falë kësaj vote iku nga pushteti. Zaevi do ishte mirë të konsolidojë elektoratin sllavomagedonas, i cili u pa se ka probleme të brendshme kur bëhet fjalë për integrimin e Perëndimit. Tabloja është më komplekse se kaq, por kur gomerët merren me shkençë devalvohet procesi. Perëndimi lipset t'i shikojë me kujdes njerëzve që analizat ua merr për bazë, sepse nuk dihet se ku mund ta kenë kërthizën, e lidhur litarin. 7 gabimet e Zaevit janë të riparueshme, por ai duhet ta kuptojë se shqiptarët e mbajtën kursin e Perëndimit e ai t'i kthehet elektoratit të vet që me elegancë e në mënyrë të pakuptueshme devijoi deri 7% anti NATO e BE. Realisht shqiptarët është e çuditshme, por kanë një durim pasi e dinë se sllavomagedonasit kanë nevojë ta ndryshojnë mentalitetin, i cili e mban peng vendin.




Opinioni *i* Ditës

# Dy protesta dhe një mësim

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë. Shumica të ardhur nga rrethet e vendit. Si për të dëshmuar atë realitet mjeran të zhvillimit të vendit tonë, që e ka përqendruar damarin e sipërmarrjes dhe vlerës së shtuar në Tiranë, Durrës dhe në disa qytete të tjera kryesore. Duke lënë gati në mëshirë të fatit mbi 500-600 mijë shqiptarë që jetojnë pa shumë mundësi dhe alternativa zhvillimi në qytetet e vogla dhe në fshat. Kush pyetet nga televizionet përse protestonte, argumentin kryesor e gjente tek mungesa e punësimit dhe për këtë fajësonte(jo me pa të drejtë) qeverinë. Në një vend të varfër, një qeveri e ka për detyrë parësore të nxisë punësimitin. Jo duke punësuar vetë(dhe këtu qëndron gabimi fatal i qeverive tona), por duke e nxitur dhe i dhënë perspektive e kurajë këtij punësimiti në sektorin privat. Realisht, pa fjalë të bukura dhe programe e projekte boshë. Programe investimi publik që punësojnë përkohësisht disa qindra vetë në betonin e derdhur pa kursim me paratë e qytetarëve në sheshet e qyteteve tona apo në projekte rrugësh që mund të prisnin edhe disa vite të tjera për t'u ndërtuar. Por që nuk ndihmojnë sa dhe si duhet sipërmarrjen vendase të shpërthejt në ide të reja biznesi apo në prodhim të shija vërtet për eksport, që të ardhurat dhe punësimi të rriten. Prandaj derdhen njerëzit në shesh. Askush nga të pakënaqurit që pamë pardje dhe më 16 shkurt 2019 nuk u prishten gjumi fort për lidhjet që qeveria ka me krimin(lidhje me kriminelë dhe "të fortë" të trafiqeve ilegale të drogës dhe mishit të bardhë ka parur çdo qeveri tek ne nga viti 1993 e deri sot). Apo për zgjedhjet e vjedhura, të cilat janë vjedhur(është shitur vota për thes me miell apo për premtim për punësim) diku qetësisht e diku tjetër me pak zhurmë në gati të gjitha garat zgjedhore që kemi bërë, duke filluar nga viti 1996. Prandaj dhe qëndruan larg nga sprovat e grupeve me kapuç xhupash në kokë nën një diell të nxehtë marsi dhe me kapele, për të mos u dalluar nga kamerat e policisë. Të përgatitur për të ushtruar dhunë(aty ku do të mund t'u lejohej) dhe të bindur ta linin dhunën, kur merrnin shenjë që të pushonin përleshjen për shkatërrim(ngaqë provokimi apo ngacimi nuk po jepte shkatërrimet e shpresuara). Këto grupe ishin si të telekomanduar, nga telefonatat që merrnin drejtuesit e tyre. Dhe dalloheshin qartë nga turma e të pakënaqurve, jo vetëm pse nuk mbështeteshin prej tyre në aktet e dhunës, por edhe se organizimin e kishin ndryshe. Të pa-



kënaqurit dhe të dëshpëruarit që protestojnë pa dhunë të planifikuar duan alternativa konkrete për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike, shpresë punësimi. Shpresë se mund të mposhtin varfërinë, në pamundësi për t'u larguar nga ky vend një orë e më parë. Këtë shpresë sprovat e derisotme të kësaj qeverie dhe buxhetit i shtetit për këtë vit nuk e furnizon si duhet. As edhe e ka furnizuar ndonjëherë tamam në këto gjashtë vitet e fundit. Asnjë program nuk është konkret dhe i orientuar të krijojë me qindra(për të mos folur për mijëra) vende pune në sektorët që mbështet. Qeveria ka planifikuar të japë miliarda euro nga paratë e shqiptarëve, për kontrata dhe projekte ndërtimi rrugësh, për kompani që i kanë të punësuarit e tyre dhe që shumëshumë, në 3-5 vitet e ardhshme mund të punësojnë përkohësisht 2-3 mijë vetë si punëtorë trasësh rrugësh. Ndërsa programet ku qeveria të hedhë 400 apo 500 milionë euro në 3-5 vjet në bujqësi apo turizëm, dhe që nga xitja e nis-mave konkrete të punësohen me mijëra deri dhjetëra mijëra vetë, këto programe mungojnë. Dhe këtë kërkojnë ata dhjetëra mijëra qytetarë që u derdhen në bulevardin kryesor të Tiranës më 16 shkurt dhe 16 mars 2019! Këtë duhet

ta mbajë mirë vath në vesh, ta ketë si mësimin më të vyer nga i gjithë ky kalvar protestash që do të vijojnë, kjo qeveri. Jo të zhytet në defaktorizimin e mëtejshëm të opozitës reale në rrugë, në denigrimin dhe goditjen ndaj saj(kjo, pse opozita me këtë që ka bërë është e vetëgoditur! Po e provokove, grushtin që ia drejton asaj e ha vetë!). Të zhgënjyerit nga politikat qeveritare të sotme që ndodhen në rrugë të madhe dhe që janë qytetarë të thjeshtë të këtij vendi, për fat të keq nuk kanë njerëzit e duhur që t'i mbështesnin në këto kërkesa konkrete të tyre(punë, punë dhe vetëm punë). Duke iu ofruar programe konkrete alternative për t'ia paraqitur qeverisë(këtë, në fakt, do të duhej opozita konstruktive e vendit, jo në telekomandimin nga dialogu normal në institucione. Megjithatë e vetëmërguar dhe me forcën e një dëshpërimi të verbër, qeveria mund t'i japë një dorë kësaj opozite, që të mos pjellë tension dhe incidente për t'u fuqizuar. Duke e faktorizuar, pse parareshit të metave që ka, e kanë

vuatur dy vjet më parë 675 mijë qytetarë të këtij vendi(shumica në pushtet do të humbë shumë më tepër, po të vijojë ta lërë opozitën të vërtiten në rrugë si minë me sahat). Qeveria dhe drejtuesit i saj duhet t'i japin opozitës një alternative të daljes nga gjendja ku ka futur veten(e jo vetëm një "kur do folim" në një takim me diasporën. Qoftë t'i japë edhe artificia ligjore, të tipit "dhe dorëheqjen me ish-deputetët e tu, po nuk e deklarove këtë dorëheqje si të paktyshme. Pra mund të kthehesh në Kuvend, prandaj po të ofroj kushtet e mëposhtme që të pranosh...". Duke ndaluar procesin e shëmtuar të krijimit të surrogatëve të deputetëve zëvendësues të Kuvendit. Sigurisht kushtet e ofruar nga qeveria nuk mund të jenë formimi i një qeverie provizore pa kryeministrin e sotëm dhe shpallja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme të përgjithshme në të njëjtën kohë ose duke i shtyrë që të dyja në shtator të këtij viti. Mirëpo në mes ka një mori propozimesh dhe kushtesh që mund t'i ofrohen opozitës së sotme reale të shqiptarëve. Asaj që ndodhet në rrugë. Mund të mos pëlqehen dhe pranohen nga kjo opozitë e dëshpëruar, por ndoshta mund të shërbejnë sadopak për të larguar dhunën nga tehu i mllëfit, pezmit dhe zemërimit të saj.

## HOROSKOPI

### DASHI

Sot duhet të mendoni me zemër dhe të mos i shikoni gjërat bardhë e zi. Ndonjëherë trajtimi i gjërave me emocion nuk është shenjë dobësie. Sot do të gjeni qetësi pranë prindërve dhe njerëzve të dashur.

### DEMI

Çfarë vlere kanë ndjenjat e mrekullueshme që keni brenda jush nëse ato qëndrojnë përgjithmonë brenda jush? Transmetimi i ndjenjave tuaja duhet të jetë përparësia jote kryesore.

### BINJAKET

Është shumë e rëndësishme që të tregoheni të kursyer në komente në lidhje me disa kolegë. Mund ta gjeni veten të përfshirë aksidentalisht në vorbullën e thashethemeve që do të dëmtonin besueshmërinë tuaj.

### GAFORJA

Rutina juaj e përditshme ka sjellë dëshpërim në jetën tuaj dhe për të pasur më shumë freksi keni nevojë për një energji të lartë. Qëndroni me njerëz që bëjnë të qeshni dhe që rrethojnë me dashamirësi.

### LUANI

Bëni çmos për të mbajtur një sjellje të kontrolluar dhe të qetë kur dikush t'ju thotë diçka irrituese sot. Ky person po përpiqet shumë që t'ju bëjë të humbni durimin dhe ju nuk duhet t'ia jepni atij apo asaj këtë kënaqësi.

### VIRGJERESHA

Ju e dini mirë se mund të mbështeteni tek të gjithë miqtë tuaj në rast nevojë. Kjo nuk është koha që të ndiheni në siklet apo të ngurroni që kërkoni ndihmë. Mos e mendoni veten si një barrë për të tjerët.

### PESHORJA

Sot do të keni pranë vetes njerëz që kanë një lloj xhelozie ndaj suksesit tuaj. Mos hiqni dorë pavarësisht sfidave, sepse në fund të bindni të gjithë se gjithçka e keni arritur falë aftësive tuaja.

### AKREPI

Nëse jeni duke u përgatitur që të merrni një vendim të rëndësishëm, përpuni ta shtyni atë për një moment tjetër. Për t'u siguruar se ju do të merrni atë që dëshironi, duhet të prisni edhe pak.

### SHIGJETARI

Do të merrni lajmë të mira nga vendi i punës. Nuk do të mungojë mirënjohja nga ana e eprorëve tuaj dhe vlerësimi mund të jetë edhe financiar. Kjo do të jetë një nxitje e mirë për të pasur më shumë sukses.

### BRICJAPI

Jeta është si një llojë me letra - dhe fatkeqësisht, nganjëherë fati nuk është dorën tuaj. Përqendroni te kartat e mira që keni dhe hidhni të këqijat sa më shpejt që të jetë e mundur. Jini aktiv në fillim të ditës. Mëngjesi është kohë e mirë për të zgjidhur një keqkuptim.

### UJORI

Ngjarjet e kësaj dite mund të krijojnë shumë pasiguri në të ardhmen tuaj të afërt, por mos r'prisni qetësinë. Mos jini tepër konservator në të menduarit tuaj tani dhe rrespektivni njerëzit që bëjnë zgjedhje që janë shumë të ndryshme nga tuajat.

### PESHQIT

Të jesh i gëzuar, të qëndrosh optimist dhe të kesh kënaqësi është ndër-marrje jashtëzakonisht të vështirë për ju sot. Kjo nuk do të thotë se gjërat do të shkojnë keq, por perceptimi nuk do të jetë ashtu siç do të dëshironit.

Partizani ka fituar 3-0 ndaj Teutës, njëjtë si në ndeshjen e fazës së parë, ku triumfoi me të njëjtat shifra. Të besuarit e Gegës nuk e ka shpërdoruar asistën e marrë ditën e shtunë nga Skënderbeu, duke dominuar që në pjesën e parë. Të kuqtë që kanë dominuar kundërshtarin në këtë fraksion, falë dhe një skeme 3-4-3 të trajnerit Gega, që ka kapur në befasi durrsakët. Goli i parë për të zotët e shtëpisë do të vijë



shumë shpejt, kur në një goditje dënimi në hyrje të zonës, skema mes Asanit dhe Telushit nxjerr në pozicion të favorshëm vlonjatën që siluron Islid Hidin për epërsinë e

### Të kuqtë shkojnë në +9 nga Kukësi

## Partizani mund Teutën dhe "vret" kampionatin

Partizanit. Goli i dytë do të vijë në minutën e 32-të, kur Asani shpërthen në kundërsulm dhe pengohet në zonë nga Kallaku, që shkakton 11 metërsh, të cilin e kthen në gol Ardit Hila duke dyfishuar rezultatin dhe duke e çuan

Partizanin të qetë në pushimin e ndeshjes. Në pjesën e dytë Partizanit është i vendosur mirë në fushën e lojës dhe nuk u lë hapësira "djemve të detit", madje shfrytëzoi kundërsulmin, si në rastin e golit të tretë, që u vulos nga

Eraldo Çinari në minutën e 85-të të takimit. Një sukses 3-0 për të kuqtë e kryeqytetit, që ngjiten në kuotën e 53 pikëve, 9 më shumë sesa Kukësi i vendit të dytë dhe shkojnë të qetë në përballjen direkte në javën e 26-të.

Trajneri i Kombëtares në të parën konferencë shtypi për Euro 2020, rrëfen pritshmëritë



Jeton Selimi

# Panuçi: Turqinë e mposhtim, Durmishaj? Lojtar pa këllqe!

Për Lenjanin deklaroi se ka preferuar Alijin e Binakun

Kombëtarja shqiptare nis fushatën eliminatore më 22 mars me sfidën e "Loro Boricit" ku do të presë Turqinë. Trajneri i Kombëtares, italiani Kristian Panuçi, ka dalë në konferencën e parë zyrtare për Euro 2020, ku ka shpjeguar zgjedhjet e tij në listën e kuqjeve dhe u është përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, duke shprehur besimin për një rezultat pozitiv në sfidën e radhës dhe duke thumbuar Durmishajin, që ka zgjedhur të luajë për Greqinë.

### Cfarë do të shohim ndryshe në këto eliminatore?

Sa i takon qasje, patjetër duhet të ndryshojmë diçka. Por jo mënyrën e lojës, kjo nuk bëhet fjalë. Patmirësisht kemi rikuperuar disa lojtarë. Ndaj diçka do ta ndryshojmë që nga ndeshja me Turqinë, mund të luajmë 4-3-3 ose 3-5-2, do ta shikojmë.

### Jeni i kënaqur me grupin e lojtarëve?

Jam i kënaqur me këta 23 lojtarë, kisha dhe të tjerë, por varet nga forma. Telefonova



Cikalleshin, por ai u dëmtua. Kemi Ndojin të dëmtuar, Binaku do të vijë, por nuk e dimë si do jetë se ka një problem muskular. Por jam i

kënaqur, sepse kemi rikuperuar Ajetin, Abrashin, Grezda më në fund ka nisur të luajë. Nuk do t'i ketë 90 minuta, por do ta shohim. Kemi

qosjen, lojtar i ri që e kam ndjekur me vëmendje gjatë gjithë dimrit.

### Lojtarë që kanë minuta apo mënyra se si kërkosh të luash?

Pak nga të gjitha. Ky grup që kam këtu luajnë të gjithë. Kemi pasur 30-40 lojtarë dhe kemi zgjedhur këto. Kaçe ka luajtur këto kohë ndërsa tashmë nuk po luan. Është shumë e rëndësishme që lojtarët të kenë minuta që të luajnë në kombëtare.

### E keni nisur me një fitore në miqësore me Turqinë. Mendoni se do të jeni në gjendje të fitoni prapë?

Fitojmë me Turqinë, mundeni me Kosovën. Ky është shqetësimi im. Se kur djemtë kanë zjarrin ndezur, janë në gjendje të bëjnë shumë mirë. Unë jam i bindur se jemi në

gjendje për të fituar ndeshjen. Turqia është një skuadër e fortë, me cilësi të madhe. Kanë ndryshuar trajnerin dhe si skuadër është më e fortë se ne, ndaj ne duhet të jemi më të fortë se ata për t'i mundur. Kam shumë besim të djemtë e mi dhe kërkoi gjithmonë të jem pozitiv.

### Vetëm 3 lojtarë anësorë...

Mund të luaj edhe pa sulmues. Balliu mund të luaj përpara. Uzuni mund të bëjë të djathtin edhe të majtin. Për këtë i kam thirrur vetëm këta. Vetëm kjo është, çështje taktike.

### Vendosni bast për 6 pikë?

Po vura bast do më skualifikojnë (qesh)

### Krijon presion çështja e pritshmërive?

Kur luan në kombëtare është e rëndësishme presioni. Kombëtare si Turqia, Islanda, Turqia është e qartë që ka presion. Është e rëndësishme për të shkuar në Europian. Të luash këtu duhet të jesh i lumtur. Dikush mund të ketë bërë edhe kontrata të mëdha për shkak të kombëtares. Nuk duhet të mos mos jemi mosmirënjohës. Unë gjithashtu kam mirënjohje të madhe për Shqipërinë. Kur dëgjoj himnin shqiptar, edhe pse sedi, më jep emocion. Jam gatë të vishem dhe të luaj. Dua këtë që ta kenë edhe lojtarët.

### Vrioni dhe Mihaj u "dogjën", mund të përdorej edhe kjo me Durmishajin?

Vrioni do të bëhet i rëndësishëm për Shqipërinë. Kam marrë vetëm 2 sulmues, si zgjidhje. Pastaj do të shikojmë nëse do të luaj me Greqinë Durmishaj. I respektoj edhe ata që kanë zgjedhur për të luajtur me kombëtare. Problemi është se njëherë thonë po, pastaj jo, pastaj të fikin celularin, pastaj të merr menaxheri të thotë është me push-

### PRECEDENTI



Presidenti i Kastriotit kërcënon kryeredaktorin e "Panorama Sport"

Të thuash të vërtetën në futbollin shqiptar është e vështirë në ditët e sotme. "Panorama Sport" denonoi pak ditë më parë vendimin e FSHF-së për licencimin e një fushe sportive pa asnjë kriter për të luajtur në Superiore si ajo e Fushë-Krujës. Të gjithë e panë se çfarë ndodhi sot në ndeshjen Kastrioti-Tirana 1-0, e cila u vendos nga një penallti skandaloze e akorduar nga gjyqtari i dhjetëra gabimeve me emrin Olsi Sokoli. Në përfundim të ndeshjes pati edhe përlëshje, duke konfirmuar edhe njëherë se ky implant nuk plotëson kriteret minimale për sigurinë. "Panorama Sport" pasqyroi pamjet e dhunës siguruar nga "Supersport" dhe vetëm një orë më pas, një telefonatë e mbërritur në redaksi në orën 16:55 nga presidenti i Kastriotit, Alban Vogli, konfirmoi se në çfarë batakua ka rënë sot një pjesë e futbollit shqiptar dhe kush e drejton atë. Drejtuesi i klubit kërtoi ta kërcënoar dhe ka fyer kryeredaktorin e gazetës "Panorama Sport", Jetmir Halilaj. Ai ka dashur ta intimidojë për publikimin e ngjarjeve të fundit, duke e kërcënuar për shkak të detyrës. Gazeta "Panorama Sport" denonon këtë akt primitiv dhe bën me dije se nuk do të tërhiqet kurrë për të thënë të vërtetën për lexuesin e saj në gjithë shqiptarinë.

### Federata rihapi dyert e stadiumit të dhunës

## Sokoli jep penallti skandaloze, dhunohet Halili e Mema

Momente tensioni në stadiumin "Redi Maloku" në fund të ndeshjes mes Kastriotit dhe Tiranës. Siç raportua nga Fushë-Kruja, në momentet e mbylljes së takimit, është goditur lojtari i Tiranës, Grent Halili, ndërsa trajneri Mema duke u afruar tek trupa e arbitrave, është ndaluar nga forcat e policisë dhe është përplasur pikërisht me këta të fundit.

Kastrioti arriti të dilte me një fitore me shumë vlera, nga sfida e javës së 25-të, në shtëpi ndaj Tiranës. Takimi i zhvilluar në stadiumin "Redi Maloku", nisi me shumë nerva për bardheblutë, ku Ngo pas disa përplasjeve me futbollistët kundërshtarë, u ndëshkua me karton të verdhë, dhe Mema duke parë që nuk mund ta qetësonte, e nxori nga fusha që në çerek orën e parë. Në minutën e 28-të, vendasit arritën të gjejnë golin e vetëm të sfidës, pas një penalltie skandaloze akorduar nga gjyqtari Olsi Sokoli, të shndërruar në gol nga Marku. Në fundin e pjesës së parë, ishte Doka që u rrëzua në zonën e Kastriotit, por për kryesorin Sokoli nuk kishte asgjë. Deri në fund, Kastrioti arriti të mbante këtë fitore, dhe tashmë në vendin e parafundit, shkoi në 24 pikë, ndërsa Tirana mbetet e shtata me 29 pikë.

### PAQE NË KURBIN


## Laçi dhe Flamurtari ndahen në barazim

Flamurtari dhe Laçi kanë ndarë nga një pikë, në ndeshjen e luajtur mes tyre. Një barazim pa gola dhe një lojë shumë e fortë ishte korniza e asaj që ndodhi në Laç. Një pjesë e parë në gjumë për të dyja skuadrat. Laçi ishte ai që donte t'i jepte pak ritëm lojës, por pa rezultat. Pjesa e dytë nisi më vullshëm, me Flamurtarin në sulm. Kurbinasi fituan metra dhe drejt fundit i kanë futur vlonjatët në zonë. Ekipet kanë marrë nga një pikë në "luftën" mes tyre. Laçi kështu mbetet në vendin e pestë me 37 pikë, ndërsa Flamurtari në vendin e gjashtë me 35 pikë, vlonjatët mund ta quajnë këtë rezultat të kënaqshëm, pasi Tirana ka humbur nga Kastrioti.



ime. Këta që bëjnë kështu nuk do të bëhen lojtarë të vërtetë. Nuk duhet të bëjnë këto lëvizje. Nuk kanë këllqe. Nuk po flas për asnjë në veçanti. E kuptoj menjëherë nëse një lojtarë do të vij apo jo. Nuk na bëjnë do të për budallenj. Po apo jo, nuk ka të mesme. Këtu ve bast. Nuk do të bëhet asnjëherë i rëndësishëm. I madh fare, e lëmë këtë pjesë. Do të flasim pas 2 vjetësh, kur të flasim. Ishte një lojtarë kur shkuam e pamë. Erdhi babai, daja, kryetari i bashkisë, menaxheri, dukej sikur ishte Mesli. Tani nuk e di ku luan. Përgjigja e tij ishte se nuk e di çfarë do të bëjë. I thashë drejtuesit të federatës se këtij do t'i vëmë kryqin.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Eshhtë stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegjetarian
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kujtj
17. Parashetë për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Eshhtë si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Eshhtë me shumë së kërkesë.
28. Cristiano bomber te Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.
33. Duken të gjata ato të pritjes.
35. Gjysmë batakua.
36. Eshhtë për medaljen e parë

37. Eshhtë kujdesi i babait.
- 39... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenistike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narnit.
49. Kapen në kujtj

**VERTIKAL**

1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Qytet japonez.
9. Eshhtë pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle epoqe.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Eshhtë thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Mund të hidhet te kromanti
5. Teket e kafes.
8. D'Istria e Helena Gjikhës
12. Smith filozof.
13. Kuke regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Modulli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë qitjeje.
19. Markë pistolette.
20. Mbylli fushatat.
21. Eshhtë dorëzim.
22. Eshhtë detar.
23. Fillojë ilustrimet.
24. Eshhtë hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifillimit.
28. Një që kuron karien.
31. Ngarjëherë duhen vënë mbi i.
33. E egër dhe e fortë.

**VERTIKAL**


34. Janë thënie e famshme.
35. Janë trupa qjellorë të tilli.
37. Inicialet e Stone regjisor
38. Memoria në computer
40. Në krye të trupave.
41. Mund të jenë diskografike.
44. Eshhtë e zakonshme për pushime
46. Skuadër greke.
47. Bel i Maupassant.
48. Eshhtë thesar.
1. E famshme ajo maqedonase.
2. Një zakon.
3. Bëjnë alarm me ar
4. Inicialet e Mallë regjisor
5. Mund të jetë telefonike
6. Ka dy faqe
7. Mund të jetë një cutter.
9. Në mes të dhomës.
10. Mbahet me bateri.
11. Përfshijnë edhe Haitin.
13. Denis i enëve me presion.
16. Paguhen për shërbime.
17. Janë ufo.
18. Ekstre me tunel.
21. Një atentat vetëvrasës.
22. Markë cigaresh.
26. Arrihet duke mundur.
28. Jonathan, regjisor i Heshtja e qengjave.
29. Eshhtë aparat me zorrë.
30. Pak servilizëm.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
32. Fatih trainer turk.
34. ... Nostra me mafiozët.
36. Mbyllin punimet.
39. Ai i shenjtë është papa.
42. Kufizojnë në teknik.
43. Fillojnë panikun.
44. Fund tuneli.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7		1		4				3
		3			5			
				8				
5	3				9			
	4	6						1
9				8				
2			4		3			
1		5					2	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	1	3	4	8	6	5	7	9
7	9	8	3	1	5	4	2	6
4	5	6	9	7	2	8	3	1
3	6	4	1	5	8	2	9	7
9	7	5	6	2	3	1	4	8
1	8	2	7	9	4	3	6	5
5	2	7	8	4	9	6	1	3
6	4	9	5	3	1	7	8	2
8	3	1	2	6	7	9	5	4

*Argëtim filozofik*

- Nëse një pemë bie në pyll dhe askush nuk është atje për ta degjuar atë, do të bëjë zhurmë?
- Një hap i vogël për njeriun, një hap i madh për njerëzimin.
- Nuk më shqetsojnë muret që kanë veshë, por veshët që kanë mure...
- Një njeri optimist beson se jetojmë në botën më të mirë të mundshme. Një pesimist ka frikë se kjo është e vërtetë.
- Shumë justifikime janë gjithmonë më pak bindëse se një.
- Çdokush që ka përjetuar një dashuri të madhe, nuk i jep rëndësi miqësisë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3		11		5	9	6	11	1	4	3	R	A	S	T	E	T	P	A	P			
12	16	15	17	6	11		15		4		12	2	U	R	A	T	U	R	H	P	A			
6		1	4	12	6	11		5	18	11	2	9	S	A	M	M	M	A	R	A	I	S		
17	18		5	4	12	6	1	4	14	2	3		I	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
2		1	7	3	2	9	7	9	2	3			P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	
14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3			G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	U	
18	4	6	9	8		4	12		7	9			B	E	T	O	N	E	K	B	O	R		
9	2	12	2	4		12	3		9	2	18		S	A	L	I	R	A	M	A				
4	8		2	3		8	6	6		6	16	15	T	O	N	T	I	T	U	L	L	I		
5	K	4	12	3		11	2	5		3	6	12	A	R	E	S	A	O						
15	U	3	6		1	2	3	4		3	2	11	2	P	J	A	R	Z	O	T	I	M	I	
17	J		9	9	15	16	4		4	9	3	2	3	A	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

TRUP TALENTE S  
O R K PANTERAT  
KEL KANDILET  
BAKUNIN ADAM  
TAMARIN CO OAK  
ME E ON AT NDU  
AT TONI K PIET  
RIT LI ZE OTTO  
K EVA DETI EIR  
ELSA PALINO IA  
TAT PIRATERIA

**FJALËKRYQI (2)**

TIRANA H RP  
ORARI B TEATER  
ROMA KABIRBEDI  
TNA BARITONI L  
UI RAMBO I  
RADI PAGANTIZMI  
A VERR ALA I  
L PARTIAK T NAT  
L LALA FERRA H  
PELLIKAN I THY  
M I JASONI E  
A PARATE PA R

*Thënie të mençura*

- Kur dikush nuk mendon çfarë thotë, thotë atë që ai mendon.
- "Një nga kënaqësitë më të mëdha në jetë, është që të bësh gjëra që të tjerët thonë se ju nuk mundeni".
- Kushdo që dëshiron, gjen kohë. Kushdo që nuk dëshiron, gjen justifikime.
- "Njeriu udhëton në jetën e tij duke u justifikuar për të kaluarën, duke u ankuar në lidhje me të tashmen, dhe i frikësuar për të ardhmen."

